

# Pedagogjia injaciane

## Hyrje në praktikë

Përkthim i **dokumentit të dytë zyrtar të pedagogjisë** për shkollat e mesme të drejtuara nga **Etërit Jezuitë**.

Dokumenti i drejtohet mësuesve që të gjithë të japin ndihmesë sa më të mirë në përgatitjen e njerëzve të pjekur, të aftë, të ditur dhe të hapur në solidaritetin për progresin e Shqipërisë së re.

Një falenderim të zjarrtë të gjithëve për bashkëpunimin në këtë botim.

Shkolla e Mesme “Pjetër Meshkalla”  
SHKODER

Botimi i parë tetor 1996

## Paraqitje

Botimi i vitit 1986 i *Karakteristikave të veprimtarisë edukative të Shoqërisë së Jezusit* ka ngjallur një interes të rinovuar për edukimin injacian në mes mësuesve, drejtuesve, nxënësve, prindërve e shumë personave të tjerë në gjithë botën. U ka dhënë atyre një kuptim identiteti e një qëllim. Dokumenti i përkthyer në 13 gjuhë, ka qenë në qendër të seminareve, të mbledhjeve e të sesioneve të studimit. Reagimet kanë qenë shumë pozitive.

Në këto vite të fundit na është drejtuar nga të gjitha anët një pyetje: “Si mund t’i bëjmë më konkrete për mësuesit parimet e orientimet e *Karakteristikave*? Si mund të futim vlerat injaciane në një pedagogji praktike për t’u përdor në marrëdhëniet reciproke të përditshme në mes mësuesve e nxënësve?”.

Komisioni Ndërkombëtar për Apostulatin e Edukimit të Shoqërisë së Jezusit (ICAJE) ka punuar për më tepër se tre vjet për t’iu përgjigjur kësaj pyetjeje. Me ndihmën e reagimeve e të këshillave të docentëve laikë e jezuitë nga të gjitha anët e botës kemi redaktuar njëra pas tjetrës shtatë boca të këtij dokumenti, që paraqet *Modelin Pedagogjik Injacion*. Megjithatë, që nga fillimi, ishim të bindur që një dokument i vetëm nuk do të mund të ndihmonte mësuesit për të bërë zbatimet pedagogjike e didaktike të kërkuara nga edukimi injacian. Anëtarët e Komisionit janë të bindur se për të futur në shkollat e jezuitëve përdorimin e rregullt të

*Modelit Pedagogjik Injacion* është thelbësor programimi i kurseve për përgatitjen e trupës mësimore në shtete të ndryshme e në shkolla të veçanta. Mësuesve nuk u mjafton një hyrje teorike në modelin. Ata kanë nevojë për një ushtrim praktik që t’u japë atyre mjetet për të reflektuar mbi përvojën e tyre në përdorimin e sigurtë dhe efikas të këtyre metodave të reja. Për këtë arsye Komisioni ka punuar që nga fillimi, mbi bazën e një **projekti** për të ndihmuar mësuesit.

### PROJEKTI I PEDAGOGJISE INJACIANE PERFSHIN:

- 1) **një dokument hyrje** mbi **Modelin Pedagogjik Injacion** si zhvillim i Pjesës së 10-të të *Karakteristikave*, dhe
- 2) **një program të formimit të vazhdueshëm për mësuesit** në nivel kombëtar e shkolle të veçantë. Programi i formimit do të duhej të zgjaste nga tre deri në katër vjet për t’u lejuar mësuesve të përvetësojnë me siguri metodat pedagogjike injaciane.

Për të bërë operativ këtë program e për të futur kurse praktike formimi në shkolla të veçanta, disa grupe edukatorësh të të gjithë botës janë duke u njohur me modelin e metodologjitë didaktike që rrjedhin prej tij. Programi ka filluar me një Seminar Ndërkombëtar, që është mbajtur në Villa Cavalleti nga 20 deri 30 prill 1993. Gjashtë persona nga secili kontinent (gjithsej rreth 40 persona nga 26 shtete) janë ftuar për t’u **instrktuar**, dmth të njohin, asimilojnë e praktikojnë

disa nga këto metodologji. Këto persona janë duke përgatitur disa seminare në vendet e tyre me qëllim që të instruktojnë ata që një herë tjetër do të organizojnë kurse formimi në nivel shkollash të veçanta.

Pa ndihmën e grupit të Villa Cavalleti dhe pjesëmarrjen e tij në seminar, nuk do të ishte e mundur t'u bëhej i njohur mësuesve tanë Projekti i Pedagogjisë Injaciane. Jam për këtë shumë mirënjohës kundrejt gjithë atyre që në gjithë botën vihen në shërbim të edukimit të jezuitëve.

Falenderoj veçanërisht anëtarët e Komisionit që kanë punuar me zell për më tepër se tre vjet, duke redaktuar shtatë boca të këtij dokumenti hyrje dhe duke përpunuar metodat pedagogjike, që përmbajnë thelbin e Projektit të Pedagogjisë Injaciane. Anëtarët e Komisionit përfaqësojnë përvojën e pikëpamjet kulturore të pjesëve më të ndryshme të botës: Atë Agustin Alonso, S.I. (Evropë), Atë Anthony Berridge, S.I. (Afrikë e Madagaskar), Atë Charles Costello, S.I.(Amerika e Veriut), Atë Daven Day, S.I. (Azia Lindore), Atë Gregory Naik, S.I. (Azia Jugore) e Atë Pablo Sada, S.I. (Amerika Latine).

Falenderoj paraprakisht Provincialët, delegatët e tyre për edukimin, docentët, drejtuesit, anëtarët e Këshillit të Institutit, bashkëpunimi e nxitja e të cilëve janë të domosdoshme për këtë përpjekje të rinovimit të apostulatit tonë edukativ.

Së fundi, falenderoj për ndihmën bujare financiare të ofruar nga tre Fondacione, që dëshirojnë të ruajnë anonimatin. Pjesëmarrja e tyre në përpjekjet tona është një shembull i konsiderueshëm i interesimit e kooperimit, që karakterizon bashkësinë edukative botërore të Shoqërisë së Jezusit.

VINCENT J. DUMINUCO, S.I.  
*Sekretar për Edukimin*  
*Shoqëria e Jezusit*

## Shënime hyrëse

1. Ky dokument zhvillon pjesën e 10-të të *Karakteristikave të Veprimtarisë Edukative të Shoqërisë së Jezusit*, në përgjigje të kërkesave të shumta për formulimin e një pedagogjie praktike, që të jetë koherente me vizionin injacian të botës e me vlerat e paraqitura në *Karakteristikat*, e të jetë efikase në transmetim. Është për këtë thelbësore që aqsa propozohet këtu të kuptohet në dritën e shpirtit injacian e të idealeve apostolike të paraqitura në *Karakteristikat*.
2. Pedagogjia e Shoqërisë ka qenë diskutuar në shumë libra dhe artikuj në rrjedhën e shekujve. Në këtë dokument trajtohen vetëm disa aspekte të kësaj pedagogjie, që lejojnë të futin një strategji konkrete të mësimdhënies. *Modeli Pedagogjik Injacian* i propozuar këtu mund të ndihmojë, të unifikojë e të vërë në jetë shumë nga parimet e formuluar në *Karakteristikat*.
3. Është e qartë se është e pamundur të propozosh sot një curriculum të vetëm për të gjitha shkollat e Shoqërisë, i njëjtë me atë

propozuar në *Ratio Studiorum* origjinal. Megjithatë është e rëndësishme e në linjë me traditën injaciane për të patur një pedagogji sistematikisht të organizuar, përmbajtja e metodat e së cilës nxisin vizionin e qartë të misionit të sotëm edukativ të Shoqërisë. Përgjegjësia e përshtatjeve kulture drejtohet më mirë në nivel kombëtar apo lokal. Në nivel më të përgjithshëm duket më me vend një model pedagogjik injacian, që ndihmon mësuesit e nxënësit të orientojnë punën e tyre në mënyrë që të jetë akademikisht solide e të formojë në të njëjtën kohë burra e gra për të tjerët.

4. Modeli pedagogjik i propozuar këtu sjell një stil e një mënyrë mësimdhënieje. Ai kërkon që komunikimi i vlerave e rritja e nxënësve të futen në programet ekzistues pa shtuar kurse të reja. Konsiderojmë të pëlqyeshëm një afrim të tillë qoftë sepse është më real në dritën e programeve tashmë të grumbulluara në pjesën më të madhe të shkollave, ashtu dhe sepse është zbuluar më efikas në ndihmën ndaj studentëve, që të bëjnë të tyret vlerat e pranishme në *Karakteristikat* e të veprojnë nën frymëzimin e tyre.
5. I japim këtij dokumenti titullin *Pedagogjia Injaciane* sepse nuk i drejtohet vetëm edukimit të propozuar në shkollat e në universitetet e Shoqërisë, por mund të jetë ndihmë në të gjitha veprimtaritë edukative,

që në njëfarë mënyre frymëzohen nga përvoja e Shën Injacit, siç e gjejmë të shprehur në *Ushtrimet Shpirtërore*, në Pjesën e IV të *Kushtetutave të Shoqërisë së Jezusit dhe në Ratio Studiorum*.

6. Pedagogjia injaciane është e frymëzuar nga feja. Por dhe ata që nuk mbështesin këtë fe mund të mbledhin sugjerime të vlefshme nga ky dokument, duke ditur që pedagogjia e frymëzuar nga Shën Injaci është thellësisht njerëzore e për këtë universale.
7. Që nga origjina e saj pedagogjia injaciane ka qenë eklektike në zgjedhjen e metodave të mësimdhënies e të përvetësimit. Vetë Injaci ka përshtatur “modus parisiensis”, metodën pedagogjike të përdorur në kohët e tij në universitetin e Parisit, duke e integruar atë me shumë parime metodologjike që kishte zhvilluar paraprakisht në *Ushtrimet Shpirtërore*. Jezuitët e shekullit të XVI sigurisht nuk zotëronin metodat e përpunuara e shkencërisht të verifikuara, psh., të psikologjisë bashkëkohore. Por kujdesi ndaj nxënësve të veçantë i bënte mësuesit jezuitë të vëmendshëm ndaj asaj që mund të ndihmonte përvetësimin e rritjen personale. Ata do të bënin të njohura në shumë pjesë të botës metodat e tyre, duke verifikuar kështu efektshmërinë universale. Këto metoda qenë mbledhur në *Ratio Studiorum*, kodi i edukimit liberal, që u bë normativ në shkollat

e Shoqërisë (një përshkrim i shkurtër i disa prej këtyre metodave gjendet në Shtesën 2).

8. Në rrjedhën e shekujve disa metoda të veçanta të përpunuara shkencërisht nga edukatorë të tjerë kanë qenë përshtatur nga pedagogjia injaciane në masën në të cilën do të mund të kontribuonin në arritjen e qëllimeve injaciane. Një karakteristikë konstante e pedagogjisë injaciane është futja e vazhdueshme dhe sistematike e këtyre metodave, të ardhura nga burime të tjera, që të kontribuojnë gjithnjë e më shumë në formimin integral – intelektual, social, moral e fetar – të personit.
9. Ky dokument është pjesë e një *projekti të gjerë rinovimi afatgjatë*, që është në zhvillim prej shumë vitesh e propozohet të ndihmojë pedagogjinë injaciane në arritjen e qëllimeve të saj nëpërmjet thellimit teorik e zbatimit praktik të metodave të përvetësuara. Faqet që vijnë më pas duhet për këtë të jenë të plotësuara me programe konkrete praktikë, që i lejojnë mësuesve të njohin e të zbatojnë me siguri metodat e modelit pedagogjik injacian. Për këtë qëllim disa edukatorë, jezuitë e laikë, të të gjithë kontinenteve janë duke u përgatitur të shërbejnë si drejtues në përpunimin e programeve të tillë formimi në nivel kombëtar e lokal.

10. *Modeli Pedagogjik Injacion* i drejtohet para së gjithash mësuesve. Idealet dhe qëllimet e edukimit injacion arrihen në të vërtetë kryesisht në marrëdhëniet e tyre të përditshme reciproke me nxënësit. Si sillen mësuesi me nxënësit e tij? Si e koncepton mësimdhënien? Si stimulon studentët në kërkim të së vërtetës?

Çfarë pritet nga nxënësit e tij? Cila është ndërgjegjia e tij profesionale e cilat janë idealet e tija? Janë këto disa elementë domethënës që mund të ndikojnë mbi formimin e rritjen e të rinjve. Atë Kolvenbach nënvizon faktin që “Shën Injaci duket të ketë vënë shembullin personal të docentit shumë më lart se sa shkenca e oratoria, si një mjet apostolik për të ndihmuar nxënësin të rritet në këto vlera pozitive”(shih Shtesa 2, 142). Është e evidente që drejtuesit, mësuesit e anëtarët e tjerë të bashkësisë edukative kanë në brendësi të shkollës një rol kyç në gjallërimin e ambientit e të metodave edukative, që favorizojnë arritjen e qëllimeve të pedagogjisë injacione. Është pra e rëndësishme që ata të njohin e mbështesin këtë projekt.

## Pedagogjia injacione

- (11) Pedagogjia është mënyra me të cilën mësuesit shoqërojnë nxënësit në rritjen e zhvillimin e tyre. Pedagogjia, art e shkencë e mësimdhënies, nuk mund të katandiset në një metodë të thjeshtë, por duhet të përfshijë një vizion të botës e një botëkuptim të njeriut ideal, që kërkon të formohet. Mbi këtë mbështetet qëllimi drejt të cilit janë orientuar gjithë aspektet e një tradicioni edukativ, nga ky rrjedhin kriteret për zgjedhjen e mjeteve për t'u përdorur në procesin e edukimit. Vizioni i botës dhe ideali i edukimit injacion janë paraqitur në *Karakteristikat e veprimtarisë edukative të Shoqërisë së Jezusit*. Pedagogjia injacione presupozon një vizion të botës, por shkon më tej e propozon mjetet konkrete për të mishëruar vlerat injacione në procesin e mësimdhënies.

## QELLIMI I EDUKIMIT INJACIAN

- (12) Cili është qëllimi ynë? Karakteristikat japin një përshkrim, që është shprehur nga Ati i Përgjithshëm Kolvenbach me këto fjalë:

*Kërkimi i zhvillimit intelektual të secilit nxënës derisa të arrijë masën e plotë të dhuntive të marra nga Hyji mbetet me plot të drejtë qëllimi thelbësor i edukimit të Shoqërisë. Ajo megjithatë nuk ka synuar asnjëherë të akumulojë vetëm një tërësi njohurish apo të përgatisë për një profesion, edhe pse kjo është e dobishme dhe e rëndësishme për të krishterë “leaders” me vlerë. Qëllimi i fundit i edukimit injacian për më tepër është kjo rritje e plotë e personit që të çon në veprim, veprim i frymëzuar nga Shpirti dhe nga prania e Jezu Krishtit, Biri i Hyjit, Njeriu për të tjerët. Qëllimi i këtij veprimi, i themeluar ai vetë mbi një inteligjencë të shëndoshë dhe i gjallëruar nga soditja për të fituar dashurinë hyjnore, shtyn nxënësit në autodisiplinë e në iniciativë, integritet e përkujdesje. Ky edukim merr në konsideratë dhe disa mënyra jo të rregullta apo sipërfaqësore mendimi, që janë jo të denja për njeriun, dhe gjëja më e rëndësishme, të rrezikshme për botën në shërbim të së cilës të gjithë janë të thirrur<sup>1</sup>.*

- (13) Atë Arrupe ka përmledhur të gjithë këtë duke përcaktuar qëllimin e edukimit tonë me shprehjen: “të formosh burra e gra për të tjerët”. Atë Kolvenbach ka përshkruar nxënësin, që del nga një shkollë e Shoqërisë si një të ri “të formuar mirë,

kompetent nga pikëpamja intelektuale, i hapur në rritjen, besimtar, i respektueshëm dhe i angazhuar të veprojë për drejtësinë në një shërbim bujar të popullit të Hyjit”. Dhe e ka përcaktuar qëllimin tonë me fjalët: “Ne synojmë të formojmë “leaders” në shërbim, burra e gra që të kenë kompetenca, ndërgjegje e pasion për punën”.

- (14) Ky qëllim kërkon një formim të plotë e të thellë të njeriut, një proces edukativ që të fton në të shkëlqyerit – në përpjekjen për të shkëlqyer, për të realizuar atë për të cilën jemi të aftë – e të përqafojmë aspektin intelektual, aspektin akademik e gjithnjë shumë më tepër. Ky formim fton në një të shkëlqyer njerëzor, modeluar mbi Krishtin e Ungjijve, që reflekton misterin e realitetin e mishërimit, që respekton dinjitetin e të gjithë njerëzve dhe shenjtërimin e gjithë universit. Janë në histori shumë shembuj të një të shkëlqyeri, konceptuar në mënyrë të ngushtë, të personave që kanë ecur para në përmasa të çuditshme mbi planin intelektual, por kanë mbetur të papjekur mbi planin e respektit dhe mbi atë moral. Fillojmë të kuptojmë që edukimi nuk i bën humanitarë e të krishterë nga ana e tij personat e shoqërinë. Nuk mbështetim më bindjen e çiltër që secili edukim, cilatdo të jenë cilësitë e tij, motivimet e qëllimet e tij, të çon në virtutin. Dhe për këtë bëhet gjithnjë e më qartë që nëse me edukimin tonë injacian duam të kemi një peshë morale në shoqëri, do të duhet të këmbëngulim në faktin që edukimi të ndodhet në një kuadër moral aqsa në një kuadër intelektual. Kjo nuk do të thotë të kemi një program

indoktrinimi, që të bën të vuash shpirtërisht apo të futim kurse teorikë vetëm spekulativë e larg realitetit. Kemi nevojë për një kuadër kërkimesh, për një proces që duhet të ballafaqohet me probleme shumë domethënës e me vlera komplekse të jetës, ashtu si dhe të mësuesve të aftë e të gatshëm për të drejtuar këto kërkime.

#### DREJT NJE PEDAGOGJIE PER FENE E DREJTESINE

- (15) Të rinjtë e të rejtat duhet të jenë të lirë të ndërmarrin një rrugë në të cilën të mund të rriten e zhvillohen si persona plotësisht njerëzorë. Në shoqërinë e sotme tentohet të konsiderohet qëllimi i edukimit në terme tepër utilitaristikë. Nënvizimi i tepërt i suksesit ekonomik mund të bëjë që të lindë një aftësi konkurruese e tepruar dhe mbizotërim i preokupimeve egoiste. Do të rezultojë që valenca njerëzore e një disipline apo i një argumenti mund të jetë e zvogëluar në ndërgjegjen e nxënësit, e kjo mund të errësojë vlerat e qëllimet e një edukimi human. Për të evituar një shtrembërim të tillë, mësuesit e shkollave të Shoqërisë propozojnë disiplinat akademike duke u nisur nga përvoja njerëzore, e vënë theksin mbi zbulimin e kërkimit e modeleve, raporteve, fakteve, pyetjeve, koncepteve, konkluzioneve, problemeve,

zgjidhjeve, implikimeve që secila disiplinë nxjerr në pah përsa i përket asaj që do të thotë të jesh një person njerëzor. Edukimi bëhet kështu një kërkim i arsyetuar me kujdes nëpërmjet të cilit nxënësi formon e riformon qëndrimet e tij të zakonshme ndaj të tjerëve e ndaj shoqërisë.

- (16) Nga pikëpamja e krishterë, modeli i jetës njerëzore – e për këtë arsye ideali i kujtdo që është i edukuar njerëzisht – është personi i Jezusit. Me fjalët e shembujt e tij, Jezusi na mëson që fuqitë njerëzore janë plotësisht të realizueshme në bashkimin tonë me Hyjin, i kërkuar e arritur në një raport dashurie, drejtësie e mbështetjeje me vëllezërit e motrat tona. Dashuria e Hyjit gjen atëherë shprehjen e saj të vërtetë në dashurinë tonë të përditshme të të afërmit, në kujdesin që kemi për të varfërit e për ata që vuajnë, në shqetësimin thellësisht njerëzor për të tjerët si pjesëtarë të popullit të Hyjit. Është një dashuri, që dëshmon fenë dhe flet nëpërmjet veprimit tonë në reliev të një bashkësie të re botërore drejtësie, dashurie e paqeje.
- (17) Misioni i Shoqërisë sot si Urdhër fetar në Kishën Katolike është shërbimi i fesë, për të cilin nxitja e drejtësisë është element thelbësor. Është një mision i radikuar në bindjen që një bashkësi e re botërore e drejtësisë, dashurisë e paqes ka nevojë për njerëz të formuar, të pajisur me kompetencë, ndërgjegje e dashuri, të burrave e grave të gatshëm për të bërë të vetën dhe të nxitin gjithçka që është plotësisht njerëzore, që angazhohen të punojnë për



lirinë e dinjitetin e të gjithë popujve e dëshirojnë ta bëjnë në bashkëpunim me të tjerët, që si ata i kushtohen riformimit të shoqërisë e strukturave të saj. Një rinovim i sistemeve tona shoqërore, ekonomike e politike që i shtyn të ushqejnë e mbrojnë njerëzimin tonë të përbashkët, të çlirojnë njerëzit që të jenë bujarë në dashurinë e tyre e në dhuntinë e tyre ndaj të tjerëve, kërkon persona të pasur me energji e burime. Kërkon njerëz të formuar në fe e drejtësi, që të kenë një ndërgjegje gjithnjë e më të gjallë të mënyrës në të cilën mund të jenë mbrojtës të aftë, veprues e model të drejtësisë, të dashurisë e të paqes së Hyjit; si brenda ashtu dhe jashtë rasteve të zakonshme, të ofrura nga jeta e nga puna e përditshme.

(18) Që këtë rrjedh që një edukim në fe e në drejtësi fillon nga respektimi i lirisë, i së drejtës e pushtetit që njerëz e bashkësi kanë për t'u kujdes për një jetë ndryshe. Kjo do të thotë të ndihmohet të rinjtë të angazhohen në sakrificën e në gëzimin, të ndajnë me të tjerët jetën e tyre, të zbulojnë që ajo që janë vlen më shumë se ajo që kanë, të kuptojnë e të çmojnë që të tjerët janë thesari i tyre më i pasur. Kjo do të thotë të ecësh me ta mbi shtigjin e tyre drejt një njohjeje më të madhe, drejt një lirieje më të madhe e një dashurie më të madhe. Është kjo një pjesë themelore e evangjelizimit tonë për të cilin Kisha na thërret.

(19) Edukimi injacian kërkon për këtë të transformojë vështrimin që të rinjtë marrin mbi vetveten e mbi të tjerët, mbi sistemet shoqërore e mbi strukturat e shoqërisë, mbi bashkësinë njerëzore

e gjithësinë në tërësi. Nëse ka realisht sukses, edukimi injacian ka si rezultat final një transformim radikal jo vetëm të mënyrave sipas të cilave zakonisht mendohet e veprohet, por edhe në mënyrën me të cilën burra e gra të pajisur me kompetencë, ndërgjegje e dashuri jetojnë në botë e kërkojnë të mirën më të madhe në të gjitha fushat në të cilat është e mundur të veprojnë, me një angazhim feje në shërbim të drejtësisë për të përmirësuar cilësinë e jetës së njerëzve, në veçanti atë të fukarenjve të gjorë, të të shtypurve dhe të braktisurve..

(20) Për të arritur qëllimet e edukimit tonë, kemi nevojë për një pedagogji që të vërë në lëvizje ambicien për të formuar burra e gra për të tjerët në botën post-moderne, në të cilën janë aktive shumë forca që i kundërvihen këtyre qëllimeve<sup>2</sup>. Kemi më tej nevojë për një formim të vazhdueshëm për vetë ne si mësues për të qenë të aftë ta çojmë në një përfundim të mirë këtë pedagogji. Nga ana tjetër, në shumë vende programet shkollore janë stabilizuar nga qeveria, dhe formimi i mësuesve është në kontrast me një pedagogji, që nxit aktivitetin e nxënësve, favorizon progresin në të të shkëlqyerit njerëzor e nxit së bashku me transmetimin e dijeve dhe aftësive, formimin në fe e në vlera si aspekte integrale të procesit të mësimdhënies. Kjo është situata konkrete në të cilën shumë prej nesh, mësues e drejtues, gjendemi duke vepruar. Kjo përbën për ne një sfidë komplekse, në masën në të cilën rimarrim çdo ditë misionin tonë për të hapur në fe breza të rinjsh, për të ecur me ta në rrugën që të çon në

besimin, për t'i ndihmuar të punojnë për një botë të drejtë të mbushur plot me dashurinë e Hyjit.

(21) Si mund ta bëjmë këtë? Pas botimit më 1986 të *Karakteristikave*, shumë mësues e drejtues të shkollave të jezuitëve kanë drejtuar këtë pyetje: “Si mund të realizojmë atë që propozohet në këtë dokument, të edukosh të rinjtë të jenë burra e gra për të tjerët, përballë realitetit të kohës sonë?”. Përgjigja duhet t'i përshtatet kulturave të shumta, duhet të jetë e përdorshme në situata të ndryshme, duhet të jetë e zbatueshme në disiplina të ndryshme: duhet për këtë të bëhet thirrje në stile e zgjedhje të shumta. Gjëja më e rëndësishme është që duhet t'i flasë mësuesve si për realitetin e mësimdhënies ashtu dhe për idealin e tij. E gjithë kjo duhet më tej të bëhet me një vëmendje të veçantë në dashurinë me zgjedhje për të varfërit, që karakterizon misionin e Kishës sot. Kemi të bëjmë me një sfidë që nuk mund të evitohet mbasi prek vetë zemrën e apostulatit edukativ të Shoqërisë. Zgjidhja nuk konsiston në shtytjen e drejtuesve e mësuesve në një vetëmohim më të madh. Duhet për më tepër të identifikojmë modele që të na thonë si të procedojmë për të nxitur qëllimin e edukimit injacian, një shembull-tip për procesin e mësimdhënie-përvetësimit, që prek marrëdhënien mësues-nxënës e të ketë kuptim e zbatim konkret për klasën.

(22) Dekreti i parë i Kongregacionit të 33-të të Përgjithshëm të Shoqërisë së Jezusit, “Shokë të Jezusit të dërguar në shoqërinë e sotme”, i këshillon jezuitëve një vlerësim konstant apostolik të

ministerit të tyre, si të ministereve tradicionale ashtu dhe të atyre të rinj. Këshillon këtu një rishikim të vëmendshëm në fjalën e Hyjit i frymëzuar prej traditës injaciane. Duhet më tej të lejojë një transformim të skemave tona të zakonshme të mendimit nëpërmjet **lidhjes reciproke konstante në mes përvojës, reflektimit dhe veprimit**<sup>3</sup>. Këtu gjejmë skicën e një modeli për t'i dhënë jetë karakteristikave të edukimit në shkollat tona të sotme, duke u kthyer në një mënyrë procedimi, që është plotësisht në marrëveshje me qëllimin e edukimit të Shoqërisë e plotësisht në linjë me misionin e saj. Vëmendja jonë përqëndrohet për këtë mbi modelin injacian, që i jep epërsi një lidhjeje reciproke në mes PERVOJES, REFLEKTIMIT DHE VEPRIMIT.

#### PEDAGOGJIA E USHTRIMEVE SHPIRTERORE

(23) Një aspekt dallues i *Modelit Pedagogjik Injacian* është që, i ndodhur në dritën e *Ushtrimeve Shpirtërore*, ai bëhet jo vetëm përshkrim i saktë i një lidhjeje reciproke në mes përvojës, reflektimit e veprimit në marrëdhëniet në mes mësuesit e nxënësit, por dhe një portret ideal i relacionit dinamik në mes mësuesit dhe nxënësit, në udhën që ky i fundit përshkon për të fituar dije e liri gjithnjë e më të mëdha.

(24) *Ushtrimet Shpirtërore* të Shën Injacit janë një libër që nuk është bërë për t'u lexuar, të paktën jo siç

janë pjesa më e madhe e librave. Ai duhet të përdoret si një rrugë që ndiqet për të drejtuar persona të tjerë në një përvojë lutjeje, në rrjedhën e së cilës ata mund të takojnë Hyjin jetësor, të bisedojnë me të e të përballojnë me kurajo të vërtetën e vlerave dhe bindjeve të tyre, në të parit e një zgjedhjeje të lirë e të shqyrtuar përsa i përket të ardhmes së jetës së vet. *Ushtrimet Shpirtërore*, të formuara e të shënuara me kujdes në manualin e Injazit, nuk janë bërë për të qenë dhe aktivitet intelektual apo praktika devocioni. Janë përkundrazi ushtrime rigoroze të shpirtit plotësisht të angazhuar në trupin, në inteligjencën, zemrën e shpirtin e njeriut. Ata propozojnë jo vetëm argumente, që duhet të peshohen me kujdes por dhe realitet për t'u soditur, skena për t'u imagjinuar, ndjenja për t'u vlerësuar, gjykime në të cilat të mbërrijmë e zgjedhje veprimesh: gjëra të gjitha që duhet të jenë të bëra me qëllimin e qartë që të ndihmojë të kërkojë e të gjejë vullnesën e Hyjit në një rishikim radikal të jetës së vet.

(25) Një nga dinamikat themelore të *Ushtrimeve Shpirtërore* është ftesa e vazhdueshme për të reflektuar mbi përvojën e jetuar në lutjen me qëllim që të vlerësosh\* ku na çon Shpirti i Hyjit. Injaci kërkon me këmbëngulje që të reflektohet mbi gjithë përvojën njerëzore, sepse ky është një mjet themelor për të verifikuar vlefshmërinë: pa një reflektim të matur mundet thjesht të gabohet, pa një reflektim të vëmendshëm kuptimi i përvojës së bërë mund të jetë i papritur apo i vlerësuar pa rëndësi. Vetëm pas një reflektimi të përshtatshëm mbi përvojën e pas një përvetësimi të brendshëm të kuptimit e të

implikimeve të asaj që studiohet, mund të procedohet lirisht e me besim drejt zgjedhjes së veprimeve që favorizojnë rritjen integrale të secilit si person njerëzor. Reflektimi është për Injacin shtylla e lëvizjes nëpërmjet së cilës kalohet nga përvoja në veprim, kështu që përgjegjësia para se ai t'i besojë drejtorit apo drejtuesit të atyre që janë angazhuar në *Ushtrimet Shpirtërore* është të lehtësojnë progresin e tyre në reflektim.

---

\* [Referonju n.(47) dhe (135) të këtij libri.

Për Injacin dinamika jetësore e *Ushtrimeve Shpirtërore* është takimi personal me Shpirtin e të së vërtetës. Prandaj nuk duhet të çuditemi nëse në parimet e në direktivat, që udhëheqin zhvillimin e *Ushtrimeve Shpirtërore* gjejmë një përshkrim të saktë të rolit pedagogjik të mësuesit, që nuk konsiston vetëm në informimin por edhe në ndihmën ndaj nxënësit që të ecë para në të vërtetën<sup>4</sup>. Për të përdor me sukses *Modelin pedagogjik injacian* mësuesit duhet të jenë të ndërjegjshëm në përvojën e tyre, në qëndrimet e opinionet e tyre, për të evituar vënien e ideve të tyre nxënësve. (shih n. 111).

MARREDHENIA MESUES-NXENES

27) Duke aplikuar modelin injacian në marrëdhëniet mësues-nxënës, roli i parë i mësuesit është të lehtësojë një raport në rritje në mes nxënësit e së vërtetës, veçanërisht përsa i përket asaj që studihet nën drejtimin e mësuesit. Mësuesi krijon kushtet, vendos bazat e bën të lindin rastet e një lidhjeje reciproke në mes PERVOJES, REFLEKTIMIT e VEPRIMIT të nxënësit.

Figura 1. – Modeli injacian dhe marrëdhëniet mësues-nxënës

(28) Duke u nisur nga PERVOJA, mësuesi krijon kushtet në të cilën nxënësit mbledhin materialin e përvojës së tyre personale që të seleksionojnë atë që tashmë kuptojnë në termat e fakteve, vlerave, botëkuptimeve e të intuitave që ata zbatojnë në lëndën e propozuar. Pastaj mësuesi vë bazat e përvetësimit duke futur nxënësit në praktikat e teknikat e REFLEKTIMIT. Këtu futen në punë kujtesa, inteligjenca, imagjinata e ndjenjat për të kuptuar domethënien e vlerën thelbësore të asaj që është studiuar, për të zbuluar lidhjen me aspekte të tjera të njohjes e aktivitetit njerëzor, për të çmuar implikimet në një kërkim të vazhdueshëm të së vërtetës. Reflektimi duhet të jetë një proces formimi e çlirimi që formon ndërgjegjen e nxënësve, qëndrimet e tyre, vlerat e bindjet e zakonshme, ashtu dhe mënyrën e tyre të menduarit, në mënyrë që ata të jenë të shtyrë të kalojnë nga të diturit në VEPRIM. Roli i mësuesit është atëherë ai i formimit të rasteve që ngjallin imagjinatën dhe vullnetin e nxënësve të zgjedhin formën e veprimit më të përshtatshëm e të nxjerrin pasojat e asaj që kanë marrë dhe ta kthejnë në realitet. Ajo që nxënësit do të bëjnë nga kjo pikëpamje nën drejtimin e mësuesve nuk do të mund të transformojë menjëherë botën në një bashkësi të madhe drejtësie, paqeje e dashurie, por do të jetë një hap në këtë drejtim edhe pse vetëm do të çojë në përvoja të reja, në reflektime të tjera e në veprime që ndjekin.

(29) Lidhja reciproke konstante në mes PERVOJES, REFLEKTIMIT dhe VEPRIMIT në dinamikën mësues-nxënës të një klase është në qendër të

pedagogjisë injaciane. Kjo lidhje reciproke është mënyra jonë për të proceduar në shkollat tona kur shoqërojmë nxënësin në udhën që përshkon për t'u bërë një person plotësisht njerëzor. Është modeli pedagogjik injacian që secili nga ne mund ta aplikojë në disiplinat që japim mësim e në programet që ndjekim, duke ditur mirë që gjithë kjo duhet të përshtatet e të aplikohet në situatat tona të veçanta.

## MODELI INJACIAN

(30) Modeli injacian i përvojës, reflektimit e veprimit sugjeron i gjithi një tërësi mjetesh me të cilët mësuesit mund të shoqërojnë nxënësit e tyre e të lehtësojnë studimin e progresin, duke i bërë të takohen me të vërtetën e duke i dërguar të eksplorojnë kuptimin e jetës. Kemi të bëjmë me një model që mund t'u ofrojë një përgjigje shumë më të përshtatshme pyetjeve kritike mbi edukimin, që sot takohen, e ka në vetvete mundësinë të shkojë përtej një teorie të pastër për t'u bërë një mjet konkret dhe efikas.

Figura 2. – Modeli injacian

(31) Një aspekt i rëndësishëm i modelit injacian është futja e reflektimit si dinamizëm thelbësor. Për shumë shekuj përgjithsisht ish pranuar që edukimi konsiston në fitimin e dijeve të akumuluar nëpërmjet leksioneve e demostrimeve<sup>5</sup>. Mësimdhënia ndiqte një model të vjetër komunikimi, në të cilin informacioni transmetohej dhe dija kalonte nga mësuesi tek nxënësi. Nxënësit dëgjonin një leksion të paraqitur qartë e plotësisht të shpjeguar, dhe mësuesi i kërkonte nxënësve të shfaqnin, shpesh duke i thënë përmendësh, nëse kishin asimiluar mirë atë që ish shpjeguar. Edhe pse kërkimet në dy dhjetëvjeçarët e fundit, të kenë shfaqur shumë e shumë herë që një përvetësim efikas është frut lidhjeje reciproke ndërmjet asaj që përvetëson me përvojën, shumë mësues kufizohen akoma sot në një model mësimi të bazuar mbi dy etapa: kalimi nga përvoja në veprim, që është një lloj mësimdhënieje në të cilën mësuesi zhvillon një rol më aktiv se nxënësi<sup>6</sup>. Ky model përshtatet shpesh kur qëllimi pedagogjik që mbizotëron është zhvillimi i teknikave të memorizimit. Nga pikëpamja e

pedagogjisë injaciane ky model është me të vërtetë i pamjaftueshëm për dy motive:

- 1) në shkollat e Shoqërisë, përvoja e përvetësimit duhet të shkojë përtej dijeve të mësuara përmendësh e të zhvillojë metoda studimi më komplekse: të kuptosh, aplikosh, analizosh, sintetizosh, vlerësosh;
- 2) nëse përvetësimi do të ndalej këtu, nuk do të ishte injacian: do të mungonte në të vërtetë momenti i REFLEKTIMIT, në të cilin nxënësit shtyhen të marrin parasysh kuptimin dhe rëndësinë njerëzore të asaj që studiojnë e të integrojnë këtë kuptim si nxënës të përgjegjshëm, që rriten si njerëz të pajisur me kompetencë, dije e dashuri.

## DINAMIKA TE MODELIT INJACIAN

- (32) Një model pedagogjik injacian i plotë duhet të ketë parasysh sa kontekstin në të cilin përvetësohet aq dhe procesin me të vërtetë pedagogjik. Duhet më tej të kërkojë mënyrat për të nxitur gatishmërinë në rritjen edhe kur ka plotësuar ciklin e studimeve. Ky përfshin pesë etapa: KONTEKST, PERVOJE, REFLEKTIM, VEPRIM, VLERESIM.
- (33) **1. KONTEKSTI I STUDIMIT.** Para se të bëhej gati të drejtonte një person në *Ushtrimet*

*Shpirtërore*, Injaci dëshironte të njihte qëndrimet ndaj Hyjit e lutjes. Dinte sa ishte e rëndësishme të jesh i hapët ndaj luhatjeve të Shpirtit nëse do të duhej të përfitoje nga itinerari që po ndërmerrej. Në bazë të kësaj njohjeje, Injaci gjykonte nëse ishte e përshtatshme të filloje takimin apo nëse do të ishte më mirë të bëje *Ushtrimet Shpirtërore* të plota apo të kufizohesh në një përvojë më të shkurtër.

- (34) Në *Ushtrimet Shpirtërore* Injaci nënvizon që përvojat e ushtruesit duhet të merren si kuadër e si kontekst të asaj që do të bëhet. Detyra e drejtuesit nuk kufizohet në zgjedhjen e ushtrimeve që i duken më të vlefshme e më të përshtatshme: ai duhet t'i modifikojë e t'i përshtatë me qëllim që t'i aplikohen direkt atij që bën takimin. Injaci këshillon që drejtuesi të familjarizohet, përse është e mundur para takimit, me përvojat e jetuara nga ushtruesi, që të mund ta ndihmojë më mirë në vlerësimin e luhatjeve të Shpirtit.
- (35) Në të njëjtën mënyrë kujdesi personal ndaj secilit, që është një aspekt karakteristik i edukimit të Shoqërisë, kërkon që mësuesi të njohë, përse është e mundur përvojën e jetës së nxënësit. Meqë përvoja njerëzore, që përbën pikënisjen e pedagogjisë injaciane, nuk bëhet kurrë në boshllëk, duhet të njohim kontekstin real në të cilin ndodhen ato që mësohen e përvetësohen. Si mësues, duhet të kuptojmë botën e nxënësve, mënyrën në të cilën familja, miqtë, bashkëmoshatarët, kultura e veshjet e nxënësve, presionet shoqërore, jeta shkollore, politika, ekonomia, besimi, mass-media, arti, muzika

dhe realitete të tjera rëndojnë në botën tonë e prekin në të mirë e të keq nxënësit tanë. Do të duhet herë pas herë të reflektojmë seriozisht me nxënësit tanë mbi realitetin që karakterizon dy botët tona. Cilat janë forcat që punojnë në ju? Në ç`mënyre eksperimentojnë këto forca, që influencojnë mbi qëndrimet e tyre, mbi vlerat e bindjet e tyre dhe që gjallërojnë mënyrat tona të perfytyrimit, gjykimit e zgjedhjes? Në ç`mënyre përvojat e botës influencojnë mbi vetë mënyrën në të cilën nxënësit studiojnë e kontribuojnë për të formuar skemat e tyre të mendimit e të veprimit? Çfarë hapash konkretë munden e duan të plotësojnë për të arritur në një liri më të madhe e në një zotërim më të madh të fatit të tyre?

(36) Një marrëdhënie autentike dhe e vërtetë në mes mësuesit e nxënësit ka nevojë për t`u zhvilluar nga një besim dhe respekt, që rriten në një përvojë të vazhdueshme të tjetrit si të një miku të çiltër në angazhimin për të përvetësuar. Kjo sjell dhe një dije të plotë e perceptim të ambientit të shkollës, dhe nga ana e drejtuesve hapje dhe vëmendje në rrjetën komplekse e shpesh të hollë të normave, të parashikimeve, të sjelljeve e të marrëdhënieve, që përbëjnë atmosferën në të cilën zhvillohet përvetësimi.

(37) Kurajoja, respekti dhe shpirti i shërbimit duhet të karakterizojnë marrëdhëniet në mes mësuesve dhe nxënësve e në mes anëtarëve të bashkësisë edukative. Ideali i një shkolle të Shoqërisë është të jetë një vend në të cilin besohet në njerëzit,

respektohet e kujdeset; në të cilin dhuntitë natyrore e aftësitë krijuese të secilit janë të njohura e të çmuara; në të cilin secili trajtohet me drejtësi dhe paanësi; në të cilin sakrificat në favor të fukarenjve, të braktisurve e të disfavorizuarve nga pikëpamja edukative janë gjë normale; në të cilin secili nga ne gjen ftesën, nxitjen dhe mbështetjen për të cilën ka nevojë për të arritur në një aktualizim të plotë personal të të shkëlqyerit; në të cilin do të ndihmojmë njëri-tjetrin e punojmë së bashku me entuziazëm dhe bujari, duke u përpjekur për të aktualizuar konkretisht në fjalë dhe veprime idealin që propozojmë për nxënësit tanë dhe për vetë ne.

(38) Mësuesit dhe anëtarët e tjerë të bashkësisë edukative duhet për këtë të kenë në konsideratë:

a) **kontekstin real në të cilin jeton nxënësi**, d.m.th. familja, kushtet shoqërore, vetë shkolla, politika, ekonomia, klima kulturore, gjendja e Kishës, mass-media, muzika dhe realitete të tjera. E gjitha kjo ndikon mbi nxënësin, në të mirën e në të keqen. Do të jetë e dobishme dhe e rëndësishme të nxitim shpesh herë nxënësit të reflektojnë mbi përvojën e tyre, mbi ndikimin që kanë elementët e kontekstit në të cilin jetojnë mbi qëndrimet e tyre, mbi mënyrën e tyre të të kuptuarit, të gjykuarit, e të zgjedhjes. Kjo është veçanërisht e rëndësishme kur trajtohen tema që ngjallin paraprakisht reaksione të forta sensibilizuese.

b) **konteksti social-ekonomik, politik e kulturor** në të cilin nxënësi rritet mund të kushtëzohet seriozisht rritjen e tij si njeri për të tjerët. Psh., një kulturë e karakterizuar nga një varfëri endemike zakonisht kushtëzon negativisht dëshirën e suksesit në studimet; një regjim politik shtypës nuk nxit kërkimin mbi ideologjitë dominuese. Këto realitete dhe shumë faktorë të tjerë mund të ngushtojnë lirinë që nxit pedagogjia injaciane.

(40) c) **ambientin institucional të shkollës**, d.m.th. rritjen komplekse dhe shpesh të hollë të normave, parashikimeve e sidomos të marrëdhënieve, që përbëjnë atmosferën e jetës shkollore. Një studim i kohëve të fundit mbi shkollat katolike nënvizon rëndësinë e një ambienti shkollor pozitiv. Në të kaluarën, përmirësimet e edukimit fetar në shkollat tona janë kërkuar zakonisht në stabilizimin e programeve të reja, suporteve audiovizive, teksteve më të përshtatshme. Këto iniciativa japin ndonjë rezultat, por në shumicën e rasteve në një masë më të ulët me parashikimet. Rezultatet e një kërkimi të kohëve të fundit tregojnë se klima e shkollës përbën kushtin e domosdoshëm që të mund të fillojë një edukim vlerash, dhe që i duhet kushtuar një vëmendje më të madhe në ambientin shkollor në të cilin ndodhin zhvillimi moral dhe formimi fetar i adoleshentëve. Konkretisht, shqetësimi për cilësinë e studimeve, besimi, respekti për të

tjerët pavarësisht ndryshimeve të opinioneve, vëmendja ndaj secilit, falja dhe shfaqja e qartë që shkolla beson në Transhendentin: ja ajo që karakterizon një ambient shkollor, që synon një rritje humane integrale. Një shkollë e Shoqërisë duhet të jetë një bashkësi feje, në të cilën mund të zhvillohen marrëdhënie të vërteta personale në mes mësuesve dhe nxënësve. Në mungesë të marrëdhënieve të tilla një pjesë e madhe e forcës së të shkëlqyerit të edukimit tonë do të humbiste. Në të vërtetë, një marrëdhënie vërtetë besimi e miqësie në mes mësuesve dhe nxënësve është kusht dhe qëndrim i domosdoshëm për çdo progres në një angazhim në vlerat. Për këtë, kujdesi personal i nxënësve, d.m.th. një dashuri e vërtetë e një vëmendje personale për secilin nga nxënësit tanë është thelbësore për të krijuar një ambient që favorizon modelin pedagogjik injacian të propozuar.

(41)d) **konceptet paraprakisht të fituara që nxënësit kanë në fillim të studimit.**

Pikëpamjet e

tyre dhe mënyrat personale të mendimit që ata mund të kenë fituar në studimet e mëparshme ose që ata kanë marrë spontanisht në ambientin e tyre kulturor, ashtu si dhe ndjenjat e tyre, qëndrimet e tyre dhe vlerat përsa i takon disiplinës për të studiuar, janë pjesë e kontekstit konkret në të cilin ata studiojnë.



(42) **2. PERVOJE**, do të thotë për Injacin “t’i shijosh gjërat në brendësi”. Kjo kërkon mbi të gjitha që të njihen faktet, konceptet, parimet, që të shqyrtohen nga afër bashkëpërcaktimet e sfumaturat e fjalëve e të ngjarjeve, që të analizohen e peshohen idetë, që të arsyetohet. Por përvoja injaciane shkon më tej se një përvetësim intelektual. Injaci insiston: gjithë personi, intelekt, zemër e vullnet – duhet të marrë pjesë në përvojën edukative. Nxit të përdor si përvojën, imagjinatën dhe ndjenjat ashtu dhe inteligjencën. Aspektet afektive duhet të angazhohen ashtu si dhe ata të njohjes sepse nëse ndjenja e brendshme nuk i bashkohet dijeve intelektuale përvetësimi nuk do të çojë personat në veprim. Psh. një gjë është të njohësh të vërtetën që Hyji është Atë, tjetër gjë është që kjo e vërtetë bëhet e gjallë dhe efikase. Injaci don që ne të *ndjejmë* dashurinë me të cilën Ati i Jezusit na don, kujdeset për ne, na fal. Kjo përvojë më e plotë mund të na shtyjë të kuptojmë që Hyji ndan këtë dashuri me të gjithë vëllezërit e motrat tona të familjes njerëzore. Në thellësinë e të qenit tonë, mund të shtyhem duke u shqetësuar për të tjerët, në gëzimet e në vuajtjet e tyre, në shpresat e tyre, në provat e tyre, në varfërinë e tyre, në situata të padrejta në të cilat jetojnë dhe të duam të bëjmë diçka për to. Këtu implikohet gjithë personi njerëzor mendje e zemër.

(43) **Termi PERVOJE përdoret për të përshkruar çdo aktivitet në të cilin tej të kuptuarit intelektual të lëndës së marrë në konsideratë, një ndjenjë e natyrës afektive provohet nga nxënësi.** Në çdo

përvojë, disa të dhëna janë perceptuar prej nxënësit si të njohura. Duke bërë pyetje, duke imagjinuar, duke shqyrtuar elementët dhe raportet, nxënësi organizon këto të dhëna në një të tërë ose në një hipotezë. “Çfarë është kjo?” A i ngjan diçkaje që tashmë njoh?”, “Si funksionon?”. Dhe pa një zgjedhje të vendosur, prodhohet në të një reaksion afektiv i njëkohshëm, psh.: “Më pëlqen”, “Më kërcënon”, “Nuk do t’ia dal kurrë në krye në këto lloj gjërash”, “Eshtë interesante”, “Më mërzit”.

(44) Në fillim të një kursi të ri, mësuesit perceptojnë shpesh në ç`mënyrë ndjenjat e nxënësve mund t’i shtyjnë drejt progresit. Eshtë e rrallë në të vërtetë që një nxënës të eksperimentojë diçka të re në studimet e tij pa iu referuar asaj që tashmë njeh. Fakte e pikëpamje të reja, ide e teori të reja janë shpesh një sfidë për çfarë nxënësi ka arritur të kuptojë. Eshtë një ftesë drejt progresit, në një kuptim më të madh, që mund të modifikojë apo ndryshojë atë që ishte konsideruar si një njohje e përshtatshme. Ballafaqimi i dijeve të reja me atë që tashmë është përvetësuar nuk mund të kufizojë të mësuarit përmendësh apo absorbimin pasiv të të dhënave të reja, sidomos nëse i riu nuk pajtohet me atë që tashmë dihet. Një nxënës mund të shqetësohet duke u kujtuar që nuk kupton mirë. Kjo e shtyn drejt një kërkimi më të thelluar – analiza, krahasim, kundërshtim, sintezë, verifikim – për të kuptuar të gjithë aktivitetet mendore e/o psikomotrikë në gjirin e të cilave ai tenton të kapë më mirë realitetin.

(45) **Përvoja njerëzore mund të jetë direkte**

## ose indirekte.

### – Direkte

Mund të lexojmë një gazetë, që tregon për një stuhi, që godet qytetet bregdetare të Porto Rikos. Mund të vihemi në dijeni me të gjitha të dhënat faktike: shpejtësia e erës, drejtimi i saj, numri i të vdekurve apo i të plagosurve, shtrirja dhe gjendja e rëndë e dëmtimeve. Kjo njohje teorike megjithatë mund ta lërë lexuesin indiferent dhe larg aspektit njerëzor të fenomenit. Krejt tjetër gjë është të gjindesh në vend, aty ku ndjehet forca e stuhisë, ku dihet që jeta, të mirat materiale, shtëpia janë në rrezik, ku ke frikë për jetën tënde dhe të tjerëve përreth, ndërsa era të shungullon ndër veshë. Ky shembull bën të shihet me qartësi që normalisht përvoja direkte është më e plotë dhe ingranuese. Në një kuadër akademik, një përvojë direkte ka vend zakonisht në përvojat ndërpersonale si një bisedë apo diskutim, një kërkim laboratorik, një udhëtim mësimor, një shërbim, një veprimtari sportive o gjëra të tjera të këtij lloji.

### – Indirekte

Në studimet përvoja direkte nuk është gjithnjë e mundur. Përvetësimi bëhet shpesh me përvojë indirekte, duke lexuar apo dëgjuar një konferencë. Për të implikuar sa më shumë nxënësit në nivel human, mësuesit duhet të stimulojnë imagjinatën e ndjeshmërinë e tyre për t'i bërë të depërtojnë më në thellësi në realitetin që studiojnë. Është e nevojshme të njohësh mirë ambientin historik, të kihet parasysh epoka, faktorët kulturorë, socialë, politikë dhe

ekonomikë që kushtëzojnë njerëzit e periudhës historike të studiuar. Në këtë fushë mund të jetë shumë e dobishme të shfrytëzojmë simulimet, dramatizimet dhe përdorimin e mjeteve audiovizivë.

(46) Në fazat e para të përvojës, direkte apo indirekte që të jetë, ata që përvetësojnë perceptojnë të dhënat njëkohësisht me reagimet e tyre ndaj vetë të dhënave. Vetëm nëpërmjet një organizimi të të dhënave përvoja mund të pohohet si një e tërë që i përgjigjet pyetjeve: **“Çfarë është kjo?”** dhe **“Si reagojnë ndaj kësaj?”** Ata që përvetësojnë kanë nevojë të jenë të vëmendshëm dhe aktivë kur kuptojnë domethënien e realitetin njerëzor me të cilin ballafaqohen.

(47) **3. REFLEKTIM.** Gjatë gjithë rrjedhës së jetës së tij Injaci dinte të ishte objekt i pandryshueshëm emocionesh, thirrjesh dhe alternativash shpesh kontradiktore. Përpjekja e tij më e madhe ishte të tentonte të zbulonte se çfarë e luhatte në çdo situatë: shtytja që e çon në të mirën apo ajo që e çon në të keqen: dëshira për t'i shërbyer të tjerëve apo shqetësimi i një pohimi egoist të vetes. Ai u bë mjeshtër i zgjedhjes që është akoma sot, sepse ia doli mbanë të dallonte mirë këtë ndryshim. Për Injacin “të vlerësosh” do të thotë të qartësosh motivet e tij të brendshme dhe arsyet që qëndrojnë pas gjykimeve të tij, të vlerësosh shkaqet dhe implikimet e përvojave të tij, të peshosh zgjedhjet e mundshme dhe t'i vlerësosh në dritën e pasojave të tyre të mundshme, të zbulosh atë që më mirë të çon në qëllimin e

dëshiruar: të jesh një person i lirë që kërkon, gjen e çon në fund vullnesën e Hyjit në çdo situatë.

(48) Në këtë nivel **REFLEKTIMI**, kujtesa, inteligjenca, imagjinata dhe ndjenjat përdoren për të nxënë **kuptimin dhe vlerën thelbësore** të asaj që është duke u studiuar, për të zbuluar **lidhjet e saj** me aspekte të tjera të dijes e të veprimtarisë njerëzore, dhe për të **vlerësuar** implikimet e saj në kërkim të së vërtetës dhe lirisë. Ky **REFLEKTIM** është një proces formimi dhe çlirimi, që formon ndërgjegjen e nxënësve (bindjet, vlerat, qëndrimet e mënyrat e mendimit) në mënyrë të tillë që ata të drejtohen të shkojnë përtej dijeve dhe të angazhohen në **veprim**.

(49) **Përdorim termin reflektim për të treguar konsiderimin e vëmendshëm të një disipline, të një përvoje, të një ideje, të një projekti ose të një reagimi spontan, në qëllimin për të nxënë sa më thellësisht kuptimin. Për këtë reflektimi është vijueshmëria nëpërmjet së cilës spikat domethënia e përvojës njerëzore:**

(50) • **duke kuptuar qartë të vërtetën që studiohet.** Psh.: Cilët janë supozimet e kësaj teorie të atomit, të kësaj paraqitjeje të historisë së popujve primitivë, të kësaj analize statistikore? Janë të vlefshme, janë të drejta? Janë të mundura supozime të tjera? Si do të ndryshonte paraqitja nëse supozimet do të ishin të ndryshme?

(51) • **duke kuptuar cila është origjina e ndjenjave apo e reagimeve që kam provuar në rrjedhën e**

këtyre konsideratave. Psh: “Duke studiuar këtë histori të shkurtër, çfarë më ka interesuar në veçanti? Pse? ... Çfarë më shqetëson në veçanti në këtë përkthim? Pse?”.

(52) • **duke thelluar kuptimin tim të asaj që implikon për mua dhe për të tjerët ajo që kam për-**

**vetësuar.** Psh.: Çfarë efektesh mund të kenë mbi jetën time, mbi atë të familjes sime, mbi atë të miqve të mi, mbi jetën e atyre që banojnë në qytete të varfëra, përpjekjet për të kontrolluar efektin serra?”.

(53) • **duke bërë të lindin pikëpamje personale mbi faktet, idetë, mbi realitetin dhe shtrembërimet**

**e realitetit, etj.** Psh.: Shumë mendojnë se një shpërndarje më e mirë e burimeve të shoqërisë është e dëshirueshme, për të mos thënë që është një detyrë morale. Eshtë e mundur që stili i jetës sime personale dhe gjërat që i konsideroj të detyrueshme të kontribuojnë në disekuilibrin aktual. Jam i gatshëm përcaktoj atë për të cilën realisht kam nevojë për të qenë i lumtur?”.

(54) • **duke arritur njëfarë njohjeje të atij që jam (Çfarë më shtyn dhe përse?) dhe të atij që mund**

**të jem në marrëdhënie me të tjerët.** Psh.: “Çfarë ndjenjash bën që të lindin në mua ajo mbi të cilën kam reflektuar? Pse? Jam i qetë përballë reagimit tim? Pse? Nëse nuk jam, pse?”.

(55) Një ndër sfidat më të mëdha që mësuesi takon në këtë stad të mësimdhënies është të arrijë të formulojë pyetje që zgjerojnë marrjen e dijeve të nxënësve dhe i shtynjë të marrin në konsideratë pikëpamjen e të tjerëve, veçanërisht atë të të varfërve. Këtu mësuesi mund të tentojë që t'i bëjë të detyrueshme pikëpamjet e tija. Nëse kjo ndodh, rreziku i manipulimit apo i indoktrinimit (gjë e gjitha e kundërt me shpirtin injacian) është i madh, dhe një mësues duhet të evitojë gjithçka që mund të çojë në një rrezik të tillë. Por mbetet sfida në hapjen e ndjeshmërisë së nxënësve në implikimet njerëzore të asaj që përvetësojnë, në mënyrë që të kapërcejnë përvoja të brendshme dhe të provokojnë në ta një rritje në të shkëlqyerin njerëzor.

(56) Si edukatorë këmbëngulim që gjithçka të bëhet në respekt të plotë të lirisë së nxënësit. Mund të ndodhë që, edhe pas këtij proces reflektimi, një nxënës mund të vendosë të veprojë në mënyrë egoiste. Ne e dimë që kjo është e mundur meqë si pasojë e një sërë faktorësh të zhvillimit, të pasigurisë apo të elementëve të tjerë, që normalisht ndikojnë mbi jetën e të riut, ai nuk mundet në këtë moment të rritet në sensin e një të riu altruist, të drejtësisë, etj. ... Dhe Jezusi ka përballuar reagime të këtij tipi, përshembull me të riun e pasur. Duhet të

respektojmë lirinë që të riut i duhet për t'u rritur. Jemi mbjellës: Providenca e Hyjit mund të bëjë të mbijë farën në kohën e duhur.

(57) Reflektimi për të cilin flasim mund dhe duhet të zgjerohet çdo herë që është e mundur që nxënësit dhe mësuesit të ndajnë reflektimet e tyre dhe të kenë mundësinë të rriten së bashku. Një reflektim i mbështetur mund të forcojë, provokojë, nxisë një konsideratë dhe të japë një siguri më të madhe që veprimi që ndërrmerret (në nivel individual apo grupi) të jetë më koherent me atë që do të thotë të jemi njerëz për të tjerët.

(58) Termat **PERVOJE** dhe **REFLEKTIM** mund të përcaktohen në mënyra të ndryshme sipas shkollave të ndryshme të pedagogjisë, dhe ne jemi dakort me tendencën në përdorim të tyre dhe të termave të tjerë të ngjashëm për të shprehur apo për të nxitur një mësimdhënie të personalizuar dhe aktive, qëllimi i së cilës të mos jetë vetëm asimilimi i lëndës por zhvillimi i personit. Në traditën injaciane të edukimit, megjithatë këto terma janë veçanërisht kuptimplotë sepse shprehin një “mënyrë procedimi” që është më efikase për të arritur “formimin integral” të nxënësit, d.m.th. një mënyrë eksperimentimi dhe reflektimi që çon nxënësin jo vetëm të gërmojë në thellësi të lëndës që studion, por të kërkojë kuptimin për jetën e të plotësojë zgjedhje personale (**VEPRIM**) në bazë të një vizioni të saktë të botës. Nga ana tjetër, dimë që përvoja dhe reflektimi nuk janë fenomene të ndashëm. Nuk është e mundur të kesh përvojë pa njëfarë shkalle reflektimi, dhe çdo

reflektim sjell me vete ndonjë përvojë intelektuale apo afektive, intuita e iluminizma, një vizion të botës, të vetvetes e të tjerëve.

(59) **4. VEPRIM** Për Injacin prova vendimtare e dashurisë është ajo që bëhet dhe jo ajo që thuhet. **“Dashuria shfaqet me vepra, jo me fjalë”**. Forca e *Ushtrimeve Shpirtërore* konsistonte saktësisht në dhënien ushtruesit të aftësisë së njohjes së vullnesës së Hyjit dhe në plotësimin lirisht të saj. Më tej Injaci dhe jezuitët e parë shqetësoheshin kryesisht për të ngjallur në studentët qëndrime, vlera, ideale në bazë të të cilave do të kishin marrë vendimet e tyre në situata të ndryshme. Injaci dëshironte që shkollat e Shoqërisë të formonin të rinj që do mundnin e dëshironin të kontribuonin me inteligjencë dhe efikasitet në mirëqënien e shoqërisë.

(60) • Reflektimi mbi pedagogjinë injaciane do të ish- te i cunguar nëse do të kufizohej në kuptimin e në reagimet afektive. Reflektimi injacian fillon me realitetin e përvojës dhe mbyllet domosdoshmërisht me të njëjtin realitet për ta kthyer në veprim. Reflektimi zhvillohet dhe piqet vetëm kur favorizon vendimin dhe angazhimin.

• Në pedagogjinë e tij Injaci nënvizon momentin afektiv-vlerësues të përvetësimit sepse din që për-  
veç të “dëgjuarit e shijuarit”, d.m.th. thellimit të përvojës vetjake, ndjenjat janë forca motivuese, që shtyjnë inteligjencën në veprim dhe

angazhim. Duhet të jetë e qartë që Injaci nuk kërkon një veprim apo angazhim çfarëdo. Por duke respektuar lirinë njerëzore, përpiqet të nxitë vendimin dhe angazhimin për *magis*, për një shërbim më të mirë Hyjit, nga ana motrave e vëllezërve tanë.

(62) • Termi “Veprim” i referohet këtu një rritjeje nje-rëzore të brendshme, që ka për bazë si një përvojë

mbi të cilën është reflektuar ashtu dhe shfaqet e saj të jashtme. **Përfshin dy etapa:**

#### 1) Zgjedhje të brendshme.

Pas reflektimit nxënësi shqyrton përvojën nga një pikëpamje humane dhe personale. Në këtë pikë në dritën e një inteligjence të njohur të përvojës e të ndjenjave (pozitive apo negative) që ndiqen, vullneti lëviz. Kuptimet e perceptuara dhe të gjykuara propozojnë zgjedhje për të bërë. Këto zgjedhje mund të paraqiten kur vendos që një e vërtetë duhet të jetë pika ime personale e referimit, qëndrimi apo përgatitja paraprake, që do të influencojë mbi çdo vendim. Kjo mund të konsistojë në një qartësim progresiv të prioriteteve të mia. Mbërritur në këtë pikë nxënësi zgjedh ta bëjë të vetën të vërtetën, duke mbetur i hapur ndaj gjithçkaje në të cilën e vërteta do të mund ta çojë.

#### 2) Zgjedhje të shfaqura nga jashtë.

Këto kuptime, qëndrime, vlera që kanë qenë të brendshme janë pra pjesë e personit dhe shtyjnë nxënësin të veprojë, **të bëjë diçka që**

**të jetë sipas kësaj bindjeje të re.** Nëse kuptimi është pozitiv, nxënësi do të kërkojë probabilitet të verifikojë kushtet dhe rrethanat në të cilat ka ndodhur përvoja e tij e parë. Psh., nëse qëllimi i edukimit fizik është arritur, do të jetë i prirur të bëjë një sport të rregullt gjatë kohës së tij të lirë. Nëse e ka me qejf letërsinë mund të vendosë t'i kushtojë kohë leximit. Nëse zbulon që ia vlen të ndihmojë shokët e tij në studim, mund të afrohet si vullnetar për të ndihmuar nxënësit më të dobët. Nëse kupton më mirë nevojat e të varfërve pasi ka bërë përvojë në një geto, do të mundte duke reflektuar mbi këtë përvojë të ndikohet në zgjedhjen e tij të karrierës apo të shtyhet në një angazhim vullnetar në favor të të varfërve. Nëse kuptimi është negativ, nxënësi do të kërkojë probabilitet të modifikojë, shtrëngojë apo shtypë kushtet apo rrethanat në të cilat është zhvilluar përvoja e tij e parë. Psh., nëse zbulon arsyet e mospjesëmarrjes së tij në punën shkollë, mund të vendosë të përmirësojë ritmet e tij për të evituar përsëritjen e mospjesëmarrjes.

(63) **5. VLERESIM.** Gjithë mësuesit dinë që është nevoja që herë pas here të vlerësojnë progreset e nxënësve në studim. Pyetjet e përditshme, verifikimet periodike me zë apo me shkrim, janë mjete të njohura mirë për të përcaktuar shkallën e asimilimit të dijeve e të metodave të studimit, progresin intelektual, boshlleqet për t'u mbushur.

Mësuesi mund të vendosë vetë nëse është e nevojshme të përdor metoda tjera mësimdhënie dhe mund të shfrytëzojë rastin për të personalizuar nxitje e këshilla.

(64) Megjithatë pedagogjia injaciane tenton në një formim, që pa dyshim përfshin por që shkon përtej rezultatit akademik. Kjo për ne ka të bëjë me rritjen integrale të nxënësve tanë si persona për të tjerët. Vlerësimi periodik i nxënësve përsa i përket qëndrimeve, prioritetëve, veprimeve koherente në të qenit persona për të tjerët është thelbësor. Një vlerësim global nuk do të mund të bëhet probabilitet me të njëjtën frekuencë me të cilën vlerësohen rezultatet shkollë, por do të duhet që ta programojmë në intervale, të paktën çdo tre apo katër muaj. Një mësues i kujdesshëm do të vërë re pastaj më shpesh shenja rritjeje apo mungesë rritjeje në diskutimet në klasë, në gatishmërinë e nxënësve për t'iu përgjegjur nevojave të shokëve, etj.

(65) Ka shumë mënyra për të vlerësuar këtë rritje personale. Duhet të merret parasysh mosha, talentet e nivelet e zhvillimit të çdo nxënësi. Marrëdhëniet e besimit dhe respektit të ndërsjellë që do të duhet të ekzistojnë në mes studentëve dhe mësuesve favorizojnë dialogun e rritjes. Një hap efikas pedagogjik përfshin mbikqyrjen, korigjimin e shënimeve personale të nxënësve, vetëvlerësimin e nxënësve në dritën e paradigmave të rritjes personale, kontrollin e veprimtarive në kohën e lirë dhe shërbimin vullnetar ndaj të tjerëve.

(66) Ky mund të jetë për mësuesin një moment i gjetur për ta përgëzuar nxënësin për progreset e tij dhe për ta nxitur si dhe për ta stimuluar në një refleksion më të thellë përballë mangësive apo boshllëqeve të pikëpamjeve të tij. Mësuesi mund të stimulojë kujtesën e nevojshme me pyetje të matura, duke i propozuar pikëpamje të reja, duke i ofruar informacione të nevojshme dhe duke i sugjeruar perspektiva të tjera.

(67) Sipas kohës qëndrimet, përparësitë, vendimet e nxënësve mund të analizohen sërish në dritën e përvojave të reja, të ndryshimeve të ndodhura në kontekstin e tyre, të sfidave nga ana e ndryshimeve kulturore apo shoqërore. Pyetjet e matura të mësuesit mund të sugjerojnë nevojën e vendimeve dhe të angazhimeve më të përshtatshme, atë që Injaci e quan *magis*. Kjo marrje e dijeve të duhura për t'u rritur mund të ndihmojë mësuesin që të depërtojë më në thellësi të *Modelit Pedagogjik Injacion*.

## NJE PROCES I VAZHDUESHEM

(68) Kjo mënyrë procedimi mund të bëhet kështu një model i vazhdueshëm dhe efikas mësimdhënieje si dhe një stimul për të qëndruar të hapur ndaj progresit për gjithë jetën.

(69) Një gjallërim i modelit mund të ndihmojë progresin e nxënësit:

- që do të mësojë gradualisht të vlerësojë dhe të jetë selektiv në zgjedhjen e përvojave;
- që do të jetë në gjendje të nxjerrë përfitime dhe bagazh nga refleksioni mbi këta përvoja;
- që do të bëhet kaq personalisht i motivuar nga fakti sa që do të kryejë vetë ai zgjedhje me vetëdije dhe përgjegjësi.

(70) Për më tepër – dhe ndoshta është gjëja më e rëndësishme – përdorimi koherent i modelit injacion mund të ketë si rezultat fitimin për gjithë jetën të zakonit për të mësuar, që nxit vëmendjen ndaj përvojës, kuptimit e të reflektuarit përtej egoizmit dhe kriteret për të vepruarit me përgjegjësi. Këto rezultate formative ishin karakteristike të ish-nxënësve të jezuitëve në Shoqërinë antike të Jezusit. Janë ndoshta edhe më të nevojshme për disa qytetarë të përgjegjshëm të mijëvjeçarit të tretë.

## TIPARE KARAKTERISTIKE TE MODELIT PEDAGOGJIK INJACION

(71) Jemi natyrisht të gatshëm të mirëpresim një pedagogji që të jetë në marrëveshje me karakteristikat e edukimit injacion dhe me qëllimet

tona si mësues. Lidhja reciproke e vazhdueshme në mes KONTEKSTIT, PERVOJES, REFLEKTIMIT, VEPRIMIT E VLERESIMIT na ofron një model pedagogjik të përshtatshëm ndaj kohëve tona e kulturës tonë. Është një model solid dhe tërheqës, që i përket direkt procesit të mësimdhënie-përvetësimit. Është një mënyrë procedimi e përpunuar me kujdes, deduktuar me një logjikë të rreptë nga parimet e përshtatshme injaciane dhe nga tradita edukative e Shoqërisë, që insiston mbi rëndësinë themelore të marrëdhënieve në mes mësuesve dhe nxënësve, në mes studentëve dhe lëndës së studimit në kontekstin real të jetës së tyre. Është një hap global dhe i plotë. Vlera e tij më e madhe qëndron në faktin se trajton në mënyrë praktike dhe të plotë sa realitetin aq idealin e mësimdhënies dhe ofron në të njëjtën kohë mjetet thelbësore për të cilat kemi nevojë për të kryer misionin tonë për të formuar burra dhe gra për të tjerët. Ndërsa vazhdojmë të punojmë për ta bërë pedagogjinë injaciane një karakteristikë thelbësore të edukimit në shkollat tona, mund të jetë e vlefshme të rikujtojmë aspektet e mëposhtme të *Modelit Pedagogjik Injacion*:

(72) • **Modeli Pedagogjik Injacion zbatohet në të gjitha programet.** Si qëndrim, mendësi, metodë e qëllim koherent, që përshkon gjithë mësimdhënien tonë, modeli mund të zbatohet në të gjithë programet, dhe në programet shtetërorë. Nuk kërkon shtimin e një kursi të caktuar, por një mënyrë të re për të mësuar disiplinat ekzistuese.

(73) • **Modeli Pedagogjik Injacion zbatohet në çdo tip mësimdhënieje.** Modeli nuk zbatohet vetëm në disiplinat shkollore por në të gjitha veprimtaritë parashkollore dhe jashtëshkollore si sport, shërbime shoqërore, takime shpirtërore. Në fushën e një disipline të veçantë (histori, matematikë, gjuhë, letërsi, fizikë, art, etj.) ofron një drejtim për përgatitjen e leksionit, për programimin, për organizimin e aktiviteteve të tjera mësimore, për lidhjet e mundshme në brendësi të disipinës, në mes disiplinave të ndryshme dhe në atë sa është kuptuar më përpara. Nëse përdoret rregullisht për një kurs të plotë studimesh, modeli i jep koherencë gjithë përvojës shkollore të nxënësit dhe kontribuon për ta mësuar që të reflektojë mbi përvojën e tij para se të veprojë.

(74) • **Modeli Pedagogjik Injacion mund të ndihmojë mësuesit të jenë mësues më të mirë.** Modeli i jep mësuesve mundësinë të pasurojnë përmbajtjen dhe strukturën e asaj që japin mësim. I jep atyre mjetet shtesë për të nxitur iniciativën e nxënësve dhe i lejon atyre të presin më shumë nga nxënësit dhe t'i bëjë thirrje nxënësve që të jenë më aktivë dhe të përgjegjshëm në procesin e tyre të përvetësimit. Ndihmon mësuesit të motivojnë studentët duke i dhënë atyre raste të raportojnë atë çfarë studiojnë në përvojat e tyre personale.

(75) • **Modeli Pedagogjik Injacion personalizon mënyrën e përvetësimit.** Modeli i kërkon nxënësve



të reflektojnë mbi vlerën e kuptimin e asaj që studiojnë, pëpiqet t'i motivojë duke i ftuar të marrin pjesë në mënyrë kritike në procesin e përvetësimit, synon në një studim më personal duke afruar në mes tyre përvojat e nxënësve dhe të mësuesve, fton të integrojmë përvojat e fituara në klasë me ato të shtëpisë, të punës, të kulturës.

(76) • *Modeli Pedagogjik Injacion nënvizon aspektin shoqëror të mësimdhënies dhe të studimit.* Mo-

deli nxit kooperimin e ngushtë, komunikimin e ndërsjelltë të përvojave dhe dialogun në mes nxënësve; vë përvetësimin dhe rritjen në raport me lidhjet reciproke personale dhe me marrëdhëniet njerëzore; propozon progresin drejt një veprimi që influencon mbi të tjerët për të mirën e tyre. Nxënësit do të mësojnë gradualisht që përvojat e tyre më të thella burojnë nga marrëdhëniet e përvojat e tyre me njerëzit. Reflektimi do të duhet të ecë gjithnjë përpara drejt një stime më të madhe të jetës së tjetrit, dhe të veprimeve, politikave dhe strukturave që favorizojnë zhvillimin reciprok dhe progresin si pjesëtarë të familjes njerëzore. Kjo kërkon natyrisht që mësuesit të njohin dhe të ndajnë këto vlera.

## SFIDA PER AKTUALIZIMIN E NJE PEDAGOGJIE INJACIANE

(77) Arritja e qëllimeve të orientuara në vlerat si ato të paraqitura nga *Karakteristikat* nuk është e lehtë. Shumë janë sfidat që duken se i kundërvihen qëllimeve tona. Ja disa:

### 1. Një konceptim i kufizuar i edukimit

(78) Qëllimi i edukimit shpesh paraqitet si një transmetim kulture, si transmetim i pjekurisë së grumbulluar në shekujt e kaluar brezit të ri.. Është sigurisht e rëndësishme të sigurojmë koherencën e përpjekjeve njerëzore në brendësi të një shoqërie e të familjes njerëzore në përgjithësi. Mungesa e informacionit dhe formimit të rinisë përta i takon asaj që kemi marrë në të kaluarën do të detyronte çdo brez të përshkonte rrugën e zbulimeve. Në realitet, në shumë vende transmetimi i kulturës është qëllimi kryesor, në mos i vetmi i edukimit publik.

(79) Por në shoqërinë e sotme, e shënuar nga ndryshime të shpejta në të gjitha nivelet e veprimtarive njerëzore dhe nga ideologji dhe sisteme vlerash në konkurrencë, qëllimi i edukimit nuk mund të mbesë kështu i ngushtë, nëse kërkon të përgatisë burra dhe gra që të jenë të aftë të japin me kompetencë e ndërgjegje kontributin e tyre në të ardhmen e familjes njerëzore. Nga një pikëpamje e pastër pragmatike, një edukim i kufizuar në transmetimin kulturor përfundon të jetë i vjetruar. Kjo është evidente nëse merren parasysh programet e

formimit teknik. Ndërkaq është më pak e qartë nëse merren parasysh dështimet që kanë qenë në vlerësimin e implikimeve humane të zhvillimeve, që implikojnë jetën njerëzore, si inxhinieria gjenetike, kultura e përfytyrimit, format e reja të enërgjisë, roli i vendeve ekonomikisht emergjente dhe të reja të tjera të panumërta që premtojnë progres. Shumë nga këto realitete hapin shpresën e një jete më të mirë cilësore, por me çfarë çmimi? Probleme të kësaj natyre nuk mund t'u përcillen thjesht politikanëve apo industrialistëve; çdo qytetar ka detyrën dhe të drejtën të gjykojë e të veprojë sipas mënyrave të përvetësuara në favor të bashkësisë njerëzore, që është duke u ndërtuar. Njerëzit duhet të edukohen që të jenë qytetarë të përgjegjshëm.

(80) Për këtë, përveç transmetimit kulturor është thelbësore përgatitja në një pjesëmarrje domethënëse në rritjen kulturore. Burrat dhe gratë e mijëvjeçarit të tretë do të kenë nevojë pa dyshim për kompetenca të reja teknologjike; por do të kenë akoma më shumë nevojë për aftësinë të kuptojnë dhe kritikojnë gjithë aspektet e jetës për të marrë vendime – personale, shoqërore, morale, profesionale, fetare – që influencojnë për të mirë mbi të gjithë jetën tonë. Kriteret për këtë rritje – nëpërmes studimit, reflektimit, analizës, kritikës dhe gatishmërisë së alternativave të mundshme – janë pashmangërisht të themeluara mbi vlerat. Kjo është e vërtetë edhe nëqoftëse këto vlera nuk janë shprehur qartë. Çdo mësimdhënie komunikon vlera, dhe këto vlera mund të nxitin drejtësinë, ose t'i kundërvihen në çdo gjë apo pjesë-pjesë misionit të Shoqërisë së Jezusit.

(81) Për këtë kemi nevojë për një edukim, që tërheq vëmendjen e të rinjve mbi rrjetën e ngatërruar të vlerave, që shpesh janë të maskuara hollë në jetën moderne, në publicitetin, në muzikën, në propagandën politike, etj. – me qëllim që nxënësit të mund t'i shqyrtojnë, verifikojnë e pranojnë lirisht, me njohjen e vërtetë të shkakut.

## 2. Parësia e pragmatizmit

(82) Në dëshirën për të patur rezultate të zhvillimit ekonomik, që mund të jenë në gjithçka legjitime, shumë qeveri ngulmojnë përjashtimisht mbi aspekte praktike të edukimit. Do të rezultojë një edukim i kufizuar në përgatitjen profesionale. Ky orientim shpesh është i nxitur nga interesat e botës së biznesit edhe nëse ofrohen si pretendime kulturore. Në këto vite të fundit, në shumë pjesë të botës, institucione të shumta akademike kanë bërë me të vërtetë këtë vizion të ngushtë të edukimit. Dhe të bën përshtypje të vësh re spostimin tepër të madh në zgjedhjen e studimeve universitare nga fakultetet shoqërore filozofike e psikologjike në ato të ekonomisë, inxhinierisë, fizikës dhe biologjisë.

(83) Në edukimin injacian nuk mund të kufizohemi duke u ankuar për këtë realitet. Duhet ta përballojmë. Jemi të bindur se çdo disiplinë akademike, nëse është e drejtë me vetveten, di që vlerat që transmeton varen nga modeli i njeriut dhe shoqërisë njerëzore që vë në themel të saj. Kanë për këtë rëndësi të madhe programet, mësimdhënia,

kërkimi, metodologjitë e përdorura në institucionet shkollore dhe universitare të Shoqërisë, mbasi ne nuk pranojmë çdo vizion të pjesshëm apo të deformuar të njeriut, imazh i Hyjit. E gjitha kjo është në kontrast të hapët me institucionet edukative, që shpesh pa vetëdije nuk kujdesen për problemin qendror të personit njerëzor si pasojë e një përvetësimi të pjesshëm në disiplinat e specializuara.

(84) Kjo do të thotë që edukimi injacian duhet të insistojë mbi formimin integral të nxënësve të tij nëpërmjet kurseve themelore, që përfshijnë disiplinat humanitare, filozofike, teologjike e shoqërore si pjesë thelbësore të çdo drejtimi të specializuar. Do të mundnin më tej të futeshin në kurset e specialiteteve momente reflektimi mbi implikimet njerëzore, etike dhe shoqërore të disiplinave të studiuara.

### **3. Dëshira e zgjidhjeve të thjeshta**

(85) Shumë shoqëri bashkëkohore karakterizohen nga tendenca për të kërkuar zgjidhje të thjeshta për probleme njerëzore komplekse. Përdorimi i gjerë i sloganeve si përgjigje nuk ndihmon për të zgjidhur me efikasitet problemet. As nuk ndihmon tendenca, që vihen re në shumë vende për të adoptuar fundamentalizmin apo ekstremin tjetër shekullarizmin. Këto dy qëndrime tentojnë që të zvogëlohen dhe nuk kënaqin etjen e këtij zhvillimi human integral që shumë nga vëllezërit dhe motrat tona kërkojnë me zë të lartë.

(86) Është i qartë që edukimi injacian, që tenton të formojë personin në tërësi, duhet të mirëpresin këtë sfidë: duhet të skicojë një udhë, duhet të përdorë një pedagogji që të evitojë këto ekstreme e të ndihmojë nxënësit tanë të zënë një të vërtetë më globale dhe implikimet humane të asaj që studiojnë, që të mund të marrin pjesë më me efikasitet në shërimin e familjes njerëzore dhe në ndërtimin e një shoqërie më humane dhe më hyjnore.

### **4. Sensi i pasigurisë**

(87) Në mes motiveve kryesore të kërkimit të përhapur të zgjidhjeve të thjeshta është pasiguria që shumë provojnë përballë shembjes së shumë institucioneve që sigurojnë normalisht kontekstin e rritjes humane. Në mënyrë tragjike, familja, shoqëria njerëzore më themelore është në rrugën e shpërbashkimit në shumë pjesë të botës. Në shumë vende të botës së parë, një martesë në dy përfundon në divorc me efekte shkatërruese për të martuarit dhe veçanërisht për fëmijët. Një tjetër burim pasigurie dhe konfuzioni është për t'u kërkuar në faktin që jemi duke jetuar një migracion historik të popujve në gjithë faqen e dheut. Miliona burra, gra e fëmijë janë çrrënjësuar nga kulturat e tyre për motive shtypjeje, konfliktesh civile, mungese ushqimi dhe mjetesesh jetese. Emigrantët më të vjetër mund të mbeten të atakuar në ndonjë element të traditave të tyre kulturore dhe fetare, por të rinjtë gjinden shpesh para konflikteve të kulturave dhe ndjehen të detyruar, për të pranuar adaptimin e vlerave të kulturës dominuese në atdheun e tyre të ri. Pasiguria shprehet shpesh në

qëndrime mbrojtjeje, egoizmi, të pretekstit për t'u vënë në vend të parë, që përjashtojnë çdo marrje parasysh të nevojave të tjerëve. Insistimi i modelit injacian mbi reflektimin mund të ndihmojë nxënësit tanë të kuptojnë arsyet e pasigurisë së tyre dhe të kërkojnë rrugë më konstruktive për t'i përballuar.

## 5. Programet e shpallura nga qeveritë

(88) Gjithë këtyre faktorëve i shtohet pluralizmi i vërtetë i kohëve tona. Nuk ekziston më, siç ndodhte në shkollat e Shoqërisë së shekullit të XVI, një program i vetëm i njohur universal si Trivium apo Quadrivium, që mund të përdoret si një mjet formimi për epokën tonë. Programet aktuale reflektojnë zakonisht kulturat dhe nevojat lokale, që variojnë shumë. Dhe në shumë vende qeveritë imponojnë në mënyrë rigorozë disiplinat dhe programet e shkollave fillore dhe të mesme. Kjo mund të jetë një pengesë për përpunimin e një programi që mban parasysh prioritetet formative të shkollave.

(89) Meqë modeli injacian kërkon njëfarë stil mësimdhënieje, ai përballon disiplinat shkollore më tepër me një qëndrim të brendshëm se me ndryshime apo shtesa. Shmang kështu mbingarkesën e programeve dhe paraqitjen si ndërfitje e një trupi të jashtëm në disiplinat “e rëndësishme”. (Kjo nuk përjashton mundësinë për të futur në një kontekst të veçantë, një trajtim të një vlere të veçantë etike).

## NGA TEORIA NE PRAKTIKE: PROGRAME FORMIMI PER MESUESIT

(90) Duke reflektuar mbi sa u propozua këtu, shumë mund të pyesin si është e mundur ta vëmë në praktikë. Në thelb, pak mësues praktikojnë këtë metodë në mënyrë efektive dhe të vazhdueshme. Mos të diturit si të bësh është probabilitet pengesa më e madhe në një ndryshim real në sjelljen e një mësuesi. Anëtarët e Komisionit Ndërkombëtar përfshijnë rezerva të tilla. Disa kërkime kanë treguar që shumë novacione pedagogjike kanë dështuar si pasojë e këtyre problemeve.

(91) Jemi pra për këtë të bindur që në shkollat dhe në kombet në të cilat përdoret *Modeli Pedagogjik Injacian* është e domosdoshme të parapërgatitet një program formimi për mësuesit, që nënkupton një formim të vazhdueshëm. Meqë arti i mësimdhënies fitohet me praktikën, mësuesit kanë nevojë jo vetëm për një paraqitje teorike të metodave, por dhe raste për t'i vënë në praktikë. Përveç kësaj një kurs formimi mund t'u japë në dorë mësuesve një tërësi metodash pedagogjike të përvetësuara për të zbatuar pedagogjinë injaciane, mes të cilave mund të zgjedhin ata që janë më të përshtatshme ndaj nevojave të nxënësve të tyre. Kurset e formimit për mësuesit në nivel kombëtar apo lokal janë pra pjesë thelbësore dhe integrale e *Modelit Pedagogjik Injacian*.

(92) Jemi për këtë të bindur që është e nevojshme zgjedhja e një ekip edukatorësh, të aftë t'u ofrojnë grupeve të mësuesve programe formimi dhe rregullin e përdorimit të *Modelit Pedagogjik Injacion*. Janë duke u përgatitur për këtë qëllim seminare formimi, që nxitin përshtatjet e kërkuara nga situatat lokale, sipas pedagogjisë injacione të propozuar.

#### NDIHMJA KONKRETE PER TE KUPTUAR MODELIN

- (93) Tri shtesa integrojnë këtë dokument.
- E para ofron një zhvendosje në kyçin pedagogjik të disa “Shënimeve” të Injacionit për *Ushtrimet Shpirtërore*.
  - E dyta paraqet një fjalim të Atë Kolvenbach mbi disa metoda karakteristike të pedagogjisë injacione.
  - E treta i propozon mësuesve shembuj metodash për përdorimin e *Modelit Pedagogjik Injacion*.

Formula më të shfrytëzuara për të ndihmuar mësuesit të kuptojnë dhe të përdorin me efikasitet pedagogjinë injacione do të duhet të përpunohen në nivel programimi kombëtar apo lokal.

#### FTESE NE BASHKEPUNIM

(94) Do të kuptojmë më mirë si të përshtatim dhe zbatojmë *Modelin Pedagogjik Injacion* sipas ndryshimeve të mëdha të situatave dhe të rrethanave edukative, që karakterizojnë shkollat e Shoqërisë të shpërndara në botë, sa më shumë do ta përdorim për të përmirësuar marrëdhëniet tona me nxënësit, në klasë dhe jashtë saj, dhe sa më shumë të zbulojmë mjetet konkrete dhe praktike për të përmirësuar procesin e mësimdhënie-përvetësimit. Mundet më tej të shpresojmë që zbatimi i modelit në sektorë dhe në disiplina të veçanta mund të jetë në të ardhmen i pasuruar nga përvoja e mësuesve të specializuar. Në të gjithë që jemi angazhuar në edukimin injacion do të dëshironim të përfitojmë perspektivat dhe sugjerimet që mësuesit e tjerë do të mund të na ofrojnë.

(95) Në frymën injacione të bashkëpunimit, shpresojmë që mësuesit që do të zbatojnë modelin injacion në leksionet e tyre apo në pjesë të vogla në fushën e disiplinave të tyre të veçanta do të duan të na bëjnë të ndajmë përvojat e tyre. Nga ana jonë, shpresojmë të vëmë herë pas here në dispozicion të të gjithëve ilustrime të shkurtra të modelit. Mësuesit janë për këtë të ftuar të dërgojnë relacione të sakta mbi mënyrën e tyre të përdorimit të modelit injacion në tema të veçanta në adresën e mëposhtme:

Centro Internazionale per l'Educazione  
Borgo S. Spirito, 4  
C.P. 6139

(98) **Shtesa 3:** Një listë e shkurtër procedimesh dhe metodash të përshtatshme në momente të ndryshme të *Modelit Pedagogjik Injacion*. Metodatat e radhitura rrjedhin si nga traditat edukative të jezuitëve (Shën Injaci, *Ratio Studiorum*, etj.) ashtu dhe nga metodatat pedagogjike, koherente me pedagogjinë injaciane, të vendosura kohët e fundit në qendra të tjera.

**Vini re:** Gjatë kurseve të formimit do t'u shpjegohen këto metoda mësuesve, që do të jenë në gjendje që t'i aplikojnë.

## Tregues i shtesave

(96) **Shtesa 1:** *Disa parime thelbësore të pedagogjisë ("Shënime" injaciane)*

Përshtatje e shënimeve hyrëse të Shën Injacionit për atë që propozon *Ushtrimet Shpirtërore*. Dalin në pah implikimet më të qarta pedagogjike.

(97) **Shtesa 2:** *Pedagogjia injaciane sot*

Fjalim i Atë Peter-Hans Kolvenbach pjesëmarrësve në Seminarin Ndërkombëtar mbi temën: "Pedagogjia injaciane: një përvetësim praktik" Villa Cavalletti, 29 prill 1993.

## Shtesa I

### DISA PARIME THELBESORE TE PEDAGOGJISE ("SHENIME" INJACIANE)

(99) Paraqitet këtu një transpozim i "Shënimeve", direktiva për të ndihmuar atë që propozon *Ushtrimet Shpirtërore*, në mbarim të hyrjes së pedagogjisë injaciane:

(100) 1) Me termin "përvetësim" kuptohet çdo formë përvoje, reflektimi dhe veprimi sipas së vërtetës,

dhe çdo mënyrë përgatitjeje dhe gatishmërie për të hequr atë që pengon lirinë dhe rritjen (Shënimi 1).

(101) 2) Mësuesi i shpjegon studentit mënyrën dhe renditjen e lëndës dhe jep me kujdes faktet. Ai qën-

dron në faktet dhe shton vetëm një shpjegim të shkurtër. Motivi i kësaj mënyre procedimi është që kur nxënësit, duke u nisur nga lënda e paraqitur ta kalojnë dhe ta thellojnë personalisht, të zbulojnë atë që e bën më të qartë dhe më të kuptueshme. Ky është një frut i arsyetimit të tyre, dhe jep një ndjenjë më të madhe kënaqësie në dallim nga shpjegimet dhe zhvillimet e ofruara nga mësuesi. Nuk është aq të diturit shumë që bën të kënaqur nxënësin se sa të kuptuarit dhe të shijuarit në brendësi të së vërtetës. (Shënimi 2).

(102) 3) Në çdo përvetësim ofrojmë disa shprehje intelektive për të arsyetuar dhe disa shprehje të vullnetit për të ngjallur ndjenjat (Shënimi 3).

(103) 4) Caktohen në përvetësimin kohë të përcaktuara, që normalisht korrespondojnë në pjesët logjike të

lëndës. Kjo megjithatë nuk do të thotë që çdo ndarjeje të lëndës duhet t'i caktohet një kohë fikse. Në të vërtetë mund të ndodhë që disa nxënës të jenë më të ngadaltë në arritjen e rezultateve të duhura, ndërsa të tjerë më të shpejtë, të tjerë më të shqetësuar apo të lodhur.

Do të jetë për këtë e nevojshme disa herë të shkurtuara dhe disa herë të zgjatim kohët (Shënimi 4).

(104) 5) Përfiton shumë që kush i përvishet studimit ta bëjë me zemërgjerësi dhe bujari, duke angazhuar

në studim gjithë vullnetin dhe lirinë e vet (Shënimi 5).

(105) 6) Kur mësuesi kupton se nxënësi nuk stimulohet nga asnjë përvojë, duhet ta pyesë mbi mënyrat e

kohët e studimit, duke e pyetur nëse direktivat janë kuptuar, duke u informuar mbi rezultatet e reflektimit të tij dhe kërkuar të marrë parasysh secilën nga këto pika (Shënimi 6).

(106) 7) Nëse mësuesi kupton që nxënësi ka probleme, duhet ta trajtojë me ëmbëlsi dhe përzemërsi duke

i dhënë kurajo dhe forcë për të ecur përpara, duke e ndihmuar të zbulojë të metat dhe duke i sugjeruar mjetet për t'u përmirësuar (Shënimi 7).

(107) 8) Nëse gjatë reflektimeve të tij nxënësi provon entuziazëm apo demoralizim, duhet të reflektojë më në thellësi mbi shkaqet e ndjenjave të tilla. Bisedat me një mësues mbi këto tema mund ta ndihmojnë nxënësin të identifikojë disiplinat që nxisin apo frenojnë rritjen e tij (Shënimi 8, 9, 10).

- (108) 9) Nxënësi do të duhej të angazhohej në studimin e lëndës së ditës sikurse nuk do të duhej të studio-  
nte tjetër, dhe nuk do të duhet të ketë nxitim të dijë gjithçka. “*Non multa, sed multum*”. (“Studioni në mënyrë të thelluar lëndën e zgjedhur; mos tentoni të përballoni të gjithë argumentat e një disipline të dhënë”) (Shënimi 11).
- (109) 10) Nxënësi duhet t`i kushtojë studimit gjithë kohën që i kërkohet. Është më mirë të zgjatet koha e studimit në vend që të shkurtohet, veçanërisht kur tundimi për të shkurtuar kohët është i fortë dhe studimi është i vështirë. Kështu studenti do të marrë zakon të ngulmojë në studim dhe do të forcohet për të ardhmen (Shënime 12 dhe 13).
- (110) 11) Kur një nxënës ka rezultate të kënaqshme, mësuesi do të duhet t`i rekomandojë më shumë kujdes dhe jo shumë nxitim (Shënimi 14).
- (111) 12) Gjatë periudhës së studimeve preferohet që të jetë vetë e vërteta ajo që motivon dhe influencon nxënësin. Mësuesi, si një peshore në ekuilibër, nuk anohet as nga njëra anë as nga tjetra, por lë që nxënësi të përballojë direkt problemin e të vërtetës dhe të lihet të influencohet nga e vërteta. (Shënimi 15).
- (112) 13) Me qëllim që Krijuesi të mund të punojë më me siguri në krijesën, do të jetë shumë e dobish-

me që nxënësi të punojë ndaj çdo pengese që pengon hapjen në të vërtetën e plotë (Shënimi 16).

- (113) 14) Nxënësi duhet të informojë me vërtetësi mësuesin për vështirësitë që takon, me qëllim që studimet të mund t`u përshtaten nevojave të tij personale (Shënimi 17).
- (114) 15) Studimet do të duhej gjithnjë t`u përshtateshin kushteve të studentëve që i ndërmarrin (Shënimi 18).
- (115) 16) (Dy Shënime e fundit lejojnë përshtatje krijuese në funksion të personave e të rrethanave. Kjo gatishmëri ndaj përshtatjes në procesin e mësimdhënie-përvetësimit ka një efikasitet të madh). (Shënime 19 dhe 20).

## Shtesa 2

### **PEDAGOGJIA INJACIANE SOT**



Fjalim i Atë Peter-Hans Kolvenbach pjesëmarrësve në Seminarin Ndërkombëtar mbi temën: “PEDAGOGJIA INJACIANE: NJË PËRVETËSIM PRAKTIK”, Villa Cavalletti, 29 prill 1993.

#### KONTEKSTI: HUMANIZMI KRISTIAN SOT

- (116) Do të filloja me lidhjen përpjekjeve tona të sotme në kontekstin e traditës edukative të Shoqërisë së Jezusit. Që nga origjina e tij në shekullin e XVI edukimi i jezuitëve i është kushtuar zhvillimit dhe transmetimit të humanizmit të pastër kristian. Ky humanizëm ka dy rrënjë: përvojat e veçanta shpirtërore të Injacist të Loyolës dhe sfidat kulturore, shoqërore dhe fetare të Evropës së Rilindjes dhe të Reformës.
- (117) Rrënja shpirtërore e këtij humanizmi gjendet në soditjen finale të *Ushtrimeve Shpirtërore*. Këtu Injaci fton ushtruesin të kërkojë një kuptim intim të mënyrës sipas së cilës Hyji është i pranishëm në njerëzit, duke i dhënë atyre inteligjencën dhe duke i transformuar sipas imazhit dhe përngjasjes së tij dhe duke marrë parasysh si Hyji punon dhe lodhet për të gjitha krijesat, për të mirën e çdo njeriu. Ky kuptim i marrëdhënieve të Hyjit me botën tregon që besimi në Hyjin dhe pohimi i gjithë asaj që është me të vërtetë humane janë të pandashme. Kjo përshpirtmëri ka bërë jezuitët e parë të përvetësojnë humanizmin e Rilindjes dhe të krijojnë një rrjet institucionesh edukative, që përtërinin dhe i përgjigjeshin nevojave urgjente të kohës së tyre. Feja dhe vlerësimi i *humanitas* shkonin me hapa të njëjtë.

(118) Pas Konkilit të II-të të Vatikanit kemi identifikuar një sfidë të re dhe të vështirë, që kërkon një formë të re të humanizmit kristian, që vë theksin mbi aspektin shoqëror. Konkili ka deklaruar që “shkëputja, që konstatohet në shumë persona, ndërmjet fesë që shfaqin dhe jetës së tyre të përditshme, konsiderohet një nga gabimet më të rënda të kohës tonë” (GS 43). Bota na duket e përçarë, e copëzuar në mijëra pjesë.

(119) Problemi bazë është ky: ç`nënkupton besimi në Hyjin përballë Bosnjës dhe Sudanit, Guatemalës dhe Haitit, Auschwitz dhe Hiroshimës në rrugët gumëzhitëse të Kalkutës dhe trupave të copëtuar në Tiananmen? Ç`është humanizmi kristian përballë miliona burrash, grash dhe fëmijësh, që vdesin urije në Afrikë? Ç`është humanizmi kristian përballë miliona njerëzish të shpërngulur prej vendeve të tyre nga persekutimi dhe terrori, dhe të shtrënguar të kërkojnë një jetë të re në tokë të huaj? Ç`është humanizmi kristian kur shohim njerëz pa shtëpi që bredhin nëpër qytetet tona dhe rritet gjithnjë numri i të varfërve të dënuar të jetojnë pa shpresë? Ç`është një edukim humanitar në këtë kontekst? Sensibilizimi në varfërinë e njerëzve dhe në shfrytëzimin e tyre nuk zvogëlohet në një doktrinë politike apo një sistem ekonomik. Është një humanizëm, një sensibilizim humanitar që duhet të rinovohet përballë kërkesave të kohës sonë dhe është frut i një edukimi, ideali i të cilit vazhdon të motivohet nga urdhërimet e mëdha – dashuri e Hyjit dhe dashuri e të afërmit.

(120) Me fjalë të tjera, humanizmi kristian në fundshekullin e XX përfshin domosdoshmërisht një humanizëm shoqëror. Si i tillë, ai ka shumë gjëra të përbashkëta me idealet e besimeve të tjera: të shfaqë konkretisht dashurinë e Hyjit duke ndërtuar mbi tokë një mbretëri Hyji të drejtë dhe të paqtë. Siç dhanë jezuitët e parë një kontribut të konsiderueshëm në humanizmin e shekullit të XVI me përtëritjet e tyre edukative, kështu edhe ne jemi thirrur sot në një angazhim të njëjtë. Kjo kërkon krijimtari në të gjitha fushat e mendimit, të edukimit, të përshtatjes, që do të jetë rezultat dhe i një pedagogjie injaciane, që i shërben fesë duke kërkuar dhe reflektuar mbi kuptimin e plotë të mesazhit kristian dhe të kërkesave të tij për kohën tonë. Ky shërbim feje dhe nxitja e drejtësisë që ai përfshin, është baza e humanizmit bashkëkohor kristian dhe është në qendër të angazhimit edukativ katolik dhe të atij të Shoqërisë. Këtij i referohen *Karakteristikat* kur flasin për “të shkëlqyerin njerëzor”. Kjo është ajo që nënkuptojmë kur themi që qëllimi i edukimit të Shoqërisë është formimi i burrave dhe grave për të tjerët, të njerëzve të pasur me kompetencë, ndërgjegje dhe punë me pasion.

#### PERGJIGJA E SHOQERISE NE KETE KONTEKST

(121) Dhjetë vjet më parë nga shumë anë të botës shtrohet kërkesa e një paraqitjeje më aktuale të parimeve thelbësore të pedagogjisë së Shoqërisë. Ndjehej nevoja në rrjedhën e ndryshimeve të dukshme, në futjen e dispozitave të reja qeveritare

përsa i përket programeve, përbërjes së klasave dhe njerëzve, në dëshirën për të qenë e mbështetur pedagogjia jonë me një numër në rritje mësuesish laikë, që nuk njihnin edukimin tonë, në dritën e misionit të Shoqërisë, në Kishën sot, dhe veçanërisht në dritën e kontekstit të ndryshuar dhe gjithnjë e më shumë shqetësues në të cilin të rinjtë rriten sot. Përgjigja jonë ishte dokumenti, që përshkruan *Karakteristikat* e veprimtarisë edukative të Shoqërisë së Jezusit sot. Por ky dokument që u prit shumë mirë ka ngjallur një pyetje dhe më urgjente. Si? Si të kalosh nga kuptimi i parimeve në marrëdhëniet reciproke të përditshme në mes mësuesve dhe studentëve? Sepse është këtu, në sfidën dhe në angazhimin e procesit të mësimdhënies-përvetësimit, që këto parime mund të jenë efikase. Ky seminar në të cilin merrni pjesë do të paraqesë metodat pedagogjike praktike që i përgjigjen pyetjes vendimtare: si transformojmë në realitet *Karakteristikat? Modeli Pedagogjik Injacion* ofron një kuadër referimi për të futur në mësimdhënien elementin vendimtar të reflektimit. Reflektimi mund t'u ofrojë vetë studentëve rastin të jenë të vetëdijshëm për kuptimin dhe implikimet e asaj që studiojnë.

(122) Në mes të shumë kërkesave të kundërta, që angazhojnë kohën dhe energjitë e tyre, nxënësit tuaj janë në kërkim të kuptimit të jetës së tyre. Ata dijnë që thërrori bërthamor nuk është vetëm fantazia e një turme. Të paktën pa vetëdije vuajnë nga frika e jetesës në një botë të bashkuar më shumë nga ekuilibri i terrorit se sa nga lidhjet e dashurisë.

Tashmë shumë të rinj janë infektuar nga interpretime shumë cinike të njeriut: është një grumbull interesash egoiste, secili prej të cilëve kërkon kënaqësi të menjëhershme; është viktima e pafajshme e sistemeve johumane mbi të cilët nuk ka asnjë kontroll. Si pasojë e presioneve ekonomike në rritje në të gjitha anët e botës, shumë studentë të vendeve të zhvilluara duken përjashtimisht të shqetësuar nga karriera dhe realizimi i tyre personal në dëm të një rritjeje njerëzore më të plotë. Kjo nuk tregon ndoshta një ndjenjë pasigurie? Por poshtë frikës së tyre, shpesh e maskuar me qëndrime të guximshme, nën mosorientimin e tyre përballë interpretimeve të kundërta të njeriut fshihet dëshira e një vizioni të vetëm unifikues të kuptimit të jetës e të ekzistencës së tyre. Në shumë vende në rrugën e zhvillimit, të rinjtë me të cilët punoni jetojnë përvojën e kërcënimit nga urija dhe të terrorit të luftës. Ata luftojnë që të mund të shpresojnë që jeta njerëzore të ketë një kuptim dhe një të ardhme nën hirin e shkatërrimit, që është mënyra e vetme që ata kanë njohur. Në vende të tjera, ku varfëria shtyp shpirtin njerëzor, mjetet moderne të komunikimit propozojnë cinikisht jetën e lumtur në termat e pasurisë dhe të konsumizmit. Pse të mos habitemi nëse studentët tanë janë konfuz dhe të pasigurtë përse i përket kuptimit që i duhet dhënë jetës?

(123) Gjatë viteve të studimeve të të tyre të mesme, të rinjtë janë akoma relativisht të lirë të dëgjojnë dhe të kërkojnë. Bota nuk është mbyllur akoma mbi ta. Drejtohen pyetje bazë mbi “pse-në” e mbi “për çfarë”. Mund të ëndërrojnë ëndrra të pamundura dhe

të entuziazmohen nga vizioni i asaj që do të mund të ishte. Shoqëria ka angazhuar shumë pjesë të njerëzve të saj dhe të burimeve të saj në edukimin e të rinjve, saktësisht sepse ato janë në kërkim të burimeve të jetës “përtej të të shkëlqyerit akademik”. Sigurisht çdo mësues i denjë për këtë emër duhet të besojë në të rinjtë dhe t'i nxitë të arrijnë majat më të larta. Kjo do të thotë që vizioni juaj unifikues i jetës duhet t'i magjepsë nxënësit tuaj dhe t'i ftojë në dialog mbi gjërat që vlejnë. Duhet t'i nxitë të bëjnë të tyret qëndrimet e dashurisë së thellë dhe universale për vëllezërit e motrat e tyre që vuajnë, dhe t'i shndërrojë në burra dhe gra të paqes dhe drejtësisë, të angazhuar të veprojnë për ndryshimin, në një botë që din sa është e përhapur padrejtësia, sa janë ndërhyrëse forcat e shtypjes, egoizmit dhe konsumizmit.

(124) Duhet të pranojmë që nuk është gjë e lehtë. Ashtu siç kemi bërë vetë ne në vitet e rinisë, nxënësit tuaj kanë pranuar pa vetëdije vlera të papajtueshme me atë që çon njerëzit në lumturinë e vërtetë. Më tepër se në brezat e kaluar, të rinjtë tuaj kanë “arsye të mira” për t'u trishtuar kur bëhen të vetëdijshëm për kërkesat e një vizioni të krishterë të jetës dhe të ndryshimit bazë të mendësisë që nuk pranon jetën në pupla dhe imazhin e shtrembëruar të ekzistencës, komunikuar nga revistat dhe nga filmat vulgarë. Ata janë të ekspozuar si ndoshta asnjë brez tjetër në kurthin e drogës dhe në largimin nga realiteti që ajo premtton.

(125) Të rinjtë tanë kanë nevojë për besim kur mendojnë për të ardhmen e tyre: kanë nevojë për forcë kur përballojnë dobësinë e tyre, kanë nevojë për përmbajtje të pjekur dhe të dashurisë për mësuesit e të gjitha disiplinave me të cilat eksplorojnë misterin e tmerrshëm të jetës. Nuk na kujtojnë ndoshta atë të ri student të Universitetit të Parisit të katër shekujve e gjysëm më parë që Iñigo afroi dhe transformoi në apostolin e Indive?

(126) Këta janë të rinjtë që duhet të bëni të jenë të hapur në Shpirtin, të gatshëm të pranojnë disfatën në dukje të dashurisë shëlbuese; me një fjalë të bëhen “leaders” plot kuptim, të gatshëm për të peshuar mbi shpatulla peshat më të rënda të shoqërisë dhe të jenë dëshmitarë të fesë që nxit drejtësinë.

(127) Ju lutem të besoni që nxënësit tuaj janë thirrur të jenë “leaders” në botën e tyre; ndihmoni të kuptojnë që duhen dhe respektohen. Lirojini nga zinxhirët e ideologjive dhe pasiguria, duke i futur në një vizion më të plotë të kuptimit të njeriut dhe duke i pajisur për shërbimin ndaj vëllezërve e motrave të tyre, të aftë dhe të angazhuar të përdorin ndikimin e tyre për të drejtuar padrejtësitë shoqërore dhe për të sjellë vlera autentike në jetën e tyre profesionale, shoqërore dhe personale. Shembulli i ndjeshmërisë suaj ndaj problemeve shoqërore e angazhimit tuaj do të jetë për ta një burim i rëndësishëm frymëzimi.

(128) Ky qëllim apostolik ka nevojë, megjithatë të shprehet në programe praktike dhe metoda të përvetësuar në botën reale të shkollës. Një nga

cilësitë karakteristike të Injacit, e zbuluar nga *Ushtrimet Shpirtërore*, nga pjesa e IV e *Kushtetutave* dhe nga shumë prej letrave të tij është ngulmimi i tij si mbi idealet më të larta ashtu dhe mbi metodat më konkrete për t'i arritur. Një vizion pa një metodë përvetësimi mund të perceptohet si steril dhe i shplarë, një metodë pa një vizion unifikues është shpesh modë e përkohshme.

(129) Një shembull i këtij integrimi injacian në mësimdhënien gjendet në *Protrepticon apo Nxitje mësuesve të shkollave të mesme të Shoqërisë* shkruar nga Atë Francesco Sacchini, zyrtari i dytë historik i Urdhërit, disa vjet pas publikimit të *Ratio* të vitit 1599. Në Prefacionin ai thekson: “Në mes nesh edukimi i rinisë nuk kufizohet me dhënien e njohurive fillestare të gramatikës, por shtrihet në formimin kristian”. Përmbledhja, (Shkurtim i Kushtetutave dhe Rregullave të Shoqërisë së Jezusit), duke e bërë të vetën dallimin në mes “mësimit” dhe “formimit”, i kuptuar si formim karakteri, pohon se mësuesit duhet të jenë të përgatitur në mënyrat e mësimdhënies dhe në artin e **edukimit**. Tradita edukative e jezuitëve ka mbrojtur gjithnjë atë që kriteri i përshtatshëm i suksesit në shkollat e tyre nuk është vetëm zotërimi i disiplinave shkollë. Prova qëndron në veprat, jo në fjalët: çfarë **do të bëjnë** nxënësit tanë nga bagazhi që kanë marrë nga edukimi i tyre? Injaci kërkonte të formonte burra dhe gra të angazhuar për të mirën e të tjerëve, dhe erudicioni nuk mjafton për këtë. Për të përdor me bujari edukimin e vet, një person duhet të jetë i mirë dhe i formuar. Nëse nuk është i formuar

nuk do të jetë në gjendje të ndihmojë të afërmin e tij me efikasitet; nëse nuk është i mirë, nuk do ta ndihmojë, apo të paktën nuk mund të shpresohet që ta bëjë seriozisht. Kjo do të thotë që edukimi injacian duhet të shkojë përtej rritjes në dije e të çojë në rritjen njerëzore, që nënkupton inteligjencë, motivim dhe bindje.

#### DIREKTIVA PEDAGOGJIKE

(130) Në marrëveshje me këtë qëllim **edukimi** me efikasitet, Shën Injaci dhe pasardhësit e tij kanë formuluar direktiva të përgjithshme pedagogjike. Kujtoj disa:

(131) a) Injaci mendonte që qëndrimi i vetë njeriut ishte ai i mrekullimit përballë dhuntive të Hyjit në kri-

jimin, gjithësinë dhe ekzistencën njerëzore. Në meditimin e tij mbi praninë e Hyjit në krijimin Injaci na kërkon të shkojmë përtej analizës racionale drejt një përgjigjeje plot përzemërsi Hyjit, që vepron për ne në gjithë gjërat. Duke gjetur Hyjin në të gjitha gjërat, zbulojmë skicën e tij të dashurisë për ne. Në hapat injacianë, imagjinata, përzemërsia, vullneti, ashtu si dhe inteligjenca kanë një vend qendror. Edukimi i Shoqërisë përfshin për këtë **formimin e gjithë personit**. Në shkollat tona jemi ftuar të integrojmë këtë aspekt më të plotë për të zhvilluar tek nxënësit tanë aftësinë të zbulojë

kuptimin e jetës, që mund të na ndihmojë të kuptojmë kush jemi dhe pse ekzistojmë dhe të na japë kritere për zgjedhjen e prirjeve tona dhe për vendimet e rëndësishme të jetës tonë. Do të zgjidhen për këtë metoda të veçanta që favorizojnë kërkimin rigoroz, kuptimin dhe reflektimin.

(132) b) Duke patur fatin të kërkojë Hyjin, Injaci respekton lirinë e Hyjit. Kjo eliminon çdo dukje in-

doktrinimi apo manipulimi. Pedagogjia e Shoqërisë do të duhet t'i bënte të rinjtë të aftë të hetojnë realitetin me mendje dhe zemër të hapur. Dhe, në përpjekjen të jesh i ndershëm, do të duhej të paralajmërosh mësuesit nga kurthet që do të mund të rridhnin nga supozimet dhe nga paragjykimet e tyre ashtu si dhe prej rrjetës së intriguar nga vlerat e sotme të rrymave që mund të bëjnë të verbër përballë së vërtetës. Për këtë edukimi injacian i shtyn nxënësit të njohin dhe të duan të vërtetën. Ai don t'i bëjë kritikë drejt një shoqërie si në pozitiven ashtu dhe në negativen, duke pranuar vlerat autentike të propozuara dhe duke mos pranuar vlerat jo të vërteta dhe të pathemelta.

(133) Shkollat tona japin kontributin e tyre thelbësor ndaj shoqërisë, duke stimuluar studimin rigoroz e

kritik të problemeve dhe të shqetësimeve të njerëzimit. Me këtë qëllim ata duhet të tentojnë në një nivel të lartë akademik. Jemi duke folur

për diçka krejt të ndryshme nga bota e lehtë dhe sipërfaqësore e sloganeve dhe e ideologjive, e përgjigjeve thjesht emocionale apo egoiste të zgjidhjeve të menjëhershme apo të thjeshtëzuara. Mësimdhënia, kërkimi dhe gjithë ajo që ka lidhje me edukimin kanë një rëndësi të madhe në shkollat tona, sepse shtyjnë dhe hedhin poshtë çdo vizion të pjesshëm apo të shtrembëruar të njeriut. E gjitha kjo qëndron në kontrast të hapur me institucionet edukative, që shpesh pa e ditur injorojnë problemin qendror të njeriut si pasojë e një afrimi të pjesshëm të realitetit në disiplinat e ndryshme specifike.

- (134) c) Injaci propozon idealin e zhvillimit të plotë të njeriut. Është tipik ngulmimi i tij mbi “*magis*”, më shumë, më e madhja lavdi e Hyjit. Në edukimin, kërkohet që parashikimet tona të shkojnë përtej nivelit të aftësisë dhe të dijes, normalisht kërkuar një student të informuar dhe kompetent. “*Magis*” nuk i referohet vetëm aspektit akademik por dhe veprimit. Në formimin e tyre jezuitët janë tradicionalisht të nxitur të eksplorojnë në përvoja të ndryshme aspektet dhe shprehjet e shërbimit kristian, si mjet për të zhvilluar shpirtin e bujarisë. Shkollat tona do të duhej të fusin këtë vizion injacian në programet e shërbimit, që stimulojnë nxënësit të eksperimentojnë dhe të vënë në provë pranimin e “*magis*”. Kështu nxënësi mund të drejtohet të zbulojë dialektikën e veprimit dhe të soditjes për të fituar dashurinë hyjnore.

- (135) d) Por jo të gjitha veprimet janë të orientura në la- vdinë më të madhe të Hyjit. Injaci ofron për këtë një rrugë për të zbuluar dhe zgjedhur vullnesën e Hyjit. “Vlerësimi” është themelor, dhe shkollat tona duhet të mësojnë të praktikojnë **reflektimin** dhe **vlerësimin**. Përballë vlerave të kundërta që ngrihen nga çdo anë, nuk është e lehtë sot të bësh zgjedhje të lira. Ndodh rrallë që motivet për një zgjedhje të jenë të gjitha nga një anë. Janë gjithnjë pro dhe kundër. **Vlerësimi** në këtë pikë bëhet themelor dhe konsiston në njohjen e të dhënave faktike, reflektimin, përzgjedhjen e motiveve që na shtyjnë, shqyrtimin e vlerave dhe prirjeve, marrjen parasysh të ndikimit që një vendim mund të ketë mbi të varfërit, të caktosh dhe jetosh zgjedhjet që bën.

- (136) e) Përgjigja thirrjes së Hyjit nuk mund të na mby- llë në vetvete, por na kërkon të jemi vetvetja e t`u mësojmë nxënësve tanë të jemi – **për të tjerët**. Vizioni i botës së Injacit ka në qendër Jezusin. Realiteti i mishërimit prek bërthamën e edukimit të Shoqërisë. Qëllimi fundit, arsyeja e vetëekzistencës së shkollave tona është të formosh burra dhe gra për të tjerët të imitojnë Jezu Krishtin – Birin e Hyjit, Njeriu për të tjerët. Prandaj edukimi ynë, besnik ndaj parimeve të mishërimit, është humanitar. Atë Arrupe shkruante:

(137) “Çfarë do të thotë të humanizosh botën, nëse nuk e vëmë në shërbim të njerëzimit?” Egoisti jo vetëm nuk humanizon krijimin material, por çnjerëzon vetë njerëzit. Ai ndryshon njerëzit në gjë duke i dominuar, shfrytëzuar dhe marrë për vete frutin e punës së tyre. Tragjedia e gjithë kësaj është që duke vepruar kështu egoisti çnjerëzon vetveten: i dorëzohet zotërimeve që dëshiron, bëhet skllav i tyre – jo më një person padron i vetvetes, por një jo – person, një gjë e udhëhequr nga dëshirat e verbëra të tija dhe nga objektet e tyre.

(138) Në ditët tona fillojmë të kuptojmë që edukimi nuk të humanizon dhe nuk të bën të krishterë automatikisht. Nuk besojmë më që çfarëdo edukimi, pavarësisht nga cilësia e tij apo nga efikasiteti i tij, apo qëllimi i tij të çon në virtyt. Bëhet për këtë gjithnjë dhe më evidente, se nëse duam të kemi një ndikim moral mbi shoqërinë duhet të nënvizojmë që edukimi duhet të drejtohet në një kontekst moral. Kjo nuk do të thotë të propozosh një program indoktrinimi që të bën të vuash shpirtërisht apo kurse teorike abstrakte dhe të largëta. Ajo që kërkohet është një stil kërkimi, në të cilin diskutimi mbi perspektivat e mëdha dhe mbi vlera të ndërlikuara të ketë vendin e tij legjitim.

(139) f) Në këtë përpjekje globale të formosh burra dhe gra të pasur me kompetencë, ndërgjegje dhe da-

shuri, Injaci nuk humbet kurrë shikimin e personit njerëzor në veçanti. Ai di që Hyji i jep secilin prej nesh dhunti të ndryshme. Nga kjo bindje rrjedh një nga karakteristikat kryesore të pedagogjisë injaciane, “*alumnorum cura personalis*”, dashuri e çiltër dhe kujdes personal për secilin nga nxënësit tanë.

## ROLI I MESUESIT ESHTË THEMELOR

(140) Në një shkollë të Shoqërisë, përgjegjësia kryesore e formimit moral dhe intelektual i përket, në istancën e fundit, jo programeve apo veprimtarive shkollore apo jashtëshkollore por mësuesit, nën drejtimin e Hyjit. Një shkollë e Shoqërisë duhet të jetë një bashkësi e hapur në të cilën të mund të zhvillohet një raport i vërtetë personale në mes mësuesve dhe nxënësve. Pa këtë raport miqësie, pjesa më e madhe e forcës tipike të edukimit tonë do të humbiste. Një raport i vërtetë besimi dhe miqësie ndërmjet mësuesit dhe nxënësit është në të vërtetë kusht shumë i rëndësishëm për t'i vënë nxënësit të rriten në angazhimin për vlerat.

(141) *Ratio* e vitit 1591 nënvizon për këtë që mësuesit duhet para së gjithash të njohin nxënësit e tyre. Këshillon që mësuesit t'i studiojnë dhe të reflektojnë mbi zakonet e tyre, difektet dhe implikimet e sjelljes së tyre në klasë. Dhe vlerëson faktin që të paktën ndonjë nga mësuesit do të duhet të njihin situatën familjare të nxënësve. Në klasë, sugjeron *Ratio* mësuesi të jetë i durueshëm dhe të dijë t'i kalojë disa

gabime dhe të shtyjë për më vonë një qortim deri në momentin psikologjikisht të përshtatshëm . Të jetë më i gatshëm në lëvdatat se në sharjet, dhe nëse duhet të qortojë ta bëjë pa ashpërsi. E gjitha kjo do të favorizohet nga një klimë miqësore e ushqyer nga kontaktet e shpeshta me nxënësit, edhe jashtë klase. Edhe këto këshilla modeste mund të shërbejnë për të konkretizuar idenë shumë të rëndësishme që shkolla është për natyrën e saj një bashkësi dhe që në të roli i mësuesit është themelor.

- (142) Në hyrjen e Pjesës së IV të *Kushtetutave* Injaci i jep **shembullit personal të mësuesit** një vlerë më të madhe, si një mjet apostolik për të ndihmuar rritjen e nxënësit ndaj përvetësimit dhe retorikës. Në brendësi të bashkësisë shkollore, mësuesi do të ketë një ndikim bindës në të mirën apo në të keqen me shembullin e tij personal. Kohët e fundit Papa Pali VI ka vënë re në Enciklikën që “sot studentët nuk i vënë veshin mësuesve por dëshmitarëve; e nëse dëgjojnë mësuesit, është sepse janë dëshmitarë”.
- (143) Si mësues në një shkollë të Shoqërisë, përveç se jeni profesionistë të kualifikuar jeni pra të thirrur të jeni burra dhe gra të Shpirtit. E doni apo jo, jeni një qytet i vendosur mbi një mal. Ajo që jeni flet më fort se sa ajo që bëni apo që thoni. Në kulturën aktuale të përfytyrimit, të rinjtë mësojnë të përgjigjen në përfytyrimin **jetësor** të idealeve që porsa ndjejnë në zemrën e tyre. Diskutimi mbi dedikimin total, mbi shërbimin ndaj të varfërve, mbi një rend shoqëror të drejtë, mbi një shoqëri jo raciste, mbi hapjen e Shpirtit mund t'i shtyjë në reflektim. Një shembull

jetësor do t'i çojë përtej reflektimit, të dëshirojnë të jetojnë atë që nënkuptojnë fjalët. Rritja jonë në Shpirt duhet për këtë të na çojë në një **jetë** të një plotësie dhe mirësie të tillë, që të stimulojë nxënësit tanë të bëhen burra dhe gra të pajisur me kompetencë, ndërgjegje dhe dashuri.

## METODA

- (144) Përvoja e tij e lodhshme edukative i ka bërë të kuptojë Injacin që entuziazmi nuk është i mjaftueshëm për të patur sukses në studimet. Janë themelore mënyrat e drejtimit të nxënësve dhe metodat e mësimdhënies. Nëse shfletojmë *Ratio*, përshtypja e parë është ajo e një akumulimi normash mbi oraret, mbi ndarjen e hollësishme të klasave, mbi zgjedhjen a autorëve për të lexuar, mbi mënyrat e ndryshme për t'u përdorur në kohë të ndryshme të mëngjesit dhe pasdites, mbi korrigjimin e detyrave dhe mbi dorëzimin e punës së shkruar, mbi nivelet e sakta të përparimit që nxënësit duhet të arrijnë për të kaluar në klasën që vjen më pas. Por të gjitha këto veçori kishin qëllimin të krijonin një kuadër referimi të saktë e të sigurtë për rregull dhe qartësi, brenda të cilit mësuesit dhe nxënësit do të mundnin të ndiqnin me siguri qëllimet e tyre. Këtu pasqyroj disa nga metodat tipike të edukimit injacian.
- (145) 1) Në një ambient kaq të rregullt dhe të përqëndruar në metodën, do të kishte qenë relativisht e



lehtë të përcaktosh **objektiva të saktë** shkollorë dhe të kufizuar për çdo klasë. Kuptohej se kjo ishte kërkesa e parë e një pedagogjie të shëndoshë – të dish atë që duhet dhe të dish si ta mbash. Mjeti karakteristik i përdorur ishte ai i **paramësimit** në të cilin mësuesi përgatiste me kujdes nxënësit për veprimtarinë e tyre të ardhshme profesionale, mjet i vetëm për të arritur përvetësim të vërtetë dhe shprehi të qëndrueshme.

- (146) 2) Metodatat e përvetësimit do të duhej pra të ishin të zgjedhura dhe të përshtatura ndaj nxënësve.

Mësuesit e parë jezuitë mendonin se dhe një fëmijë mund të mësonte shumë gjëra mjaft që të mos ngarkohej me shumë gjëra në të njëjtën kohë. Përcaktimi i **qëllimeve** dhe i **ritmeve** në përshtatje **aftësive të secilit nxënës** bëhet për këtë epërsi.

- (147) 3) Meqë njihje mirë natyrën njerëzore, Injaci kuj-tohej që një përvojë lutjeje dhe studimi edhe e or-

ganizuar mirë nuk mund të ndihmonte realisht në rritjen nëse nuk ishte e shoqëruar nga veprimtari personale. Në *Ushtrimet Shpirtërore* ai ngul këmbë mbi rëndësinë e **veprimtarisë personale** të ushtruesit. Shënimi i dytë këshillon drejtuesin të jetë i shkurtër në propozimin e lëndës, të meditimeve, të mënyrës që ushtruesi mund të zbulojë vetë të vërtetën dhe zgjedhjet

në të cilat Hyji e thërret. Ky zbulim tenton t'i japë ushtruesit “shije më të madhe dhe frut shpirtëror se sa do të kishte nëse i që propozon ushtrimet të kishte shpjeguar dhe zhvilluar gjerësisht kuptimin e misterit”. Në Shënimin e pesëmbëdhjetë shkruan: “lër që Krijuesi të veprojë direkt me krijesën, dhe krijesa me Krijuesin e saj e Zotin”. Injaci njihje tendencën e gjithë mësuesve – që të mësojnë lutjen apo historinë, shkencat – të shfaqin gjatë idetë e tyre mbi lëndën në objekt, por dinte dhe se nuk ka përvetësim pa veprimtarinë inteligjente të studentit. Për këtë në shumë ushtrime dhe studime, **veprimtaria e studentit** konsiderohej e rëndësishme.

- (148) 4) Parimi i veprimtarisë së nxënësit nënvizon rëndësinë e direktivave të detajuara nga *Ratio* mbi **përsëritjet** – ditore, javore, mujore, vjetore. Këto janë mjete të mëtejshme për të stimuluar, drejtuar dhe mbështetur nxënësin në ushtrimin e zotërimit e sigurtë të lëndës. Përsëritjet megjithatë nuk duhej të ishin një paraqitje e mërzitshme e një lënde të mësuar përmendësh, por më tepër rast i një reflektimi personal dhe aprovimi.

- (149) 5) Nëse, siç e kemi parë, nuk ka përvetësim pa veprim, po ashtu nuk ka veprim pa **motivim**. Injaci vinte re që ata që studiojnë nuk do të duhej asnjëherë të kalonin dy orët pa ndërprerje dhe rekomandonte variacion në veprimtarinë në

klasë “sepse asgjë nuk konsumon enërgjitë e të rinjve më tepër se për të bësh shumë gjatë të njëjtën gjë”. Përsa është e mundur, studimi duhet të jetë i këndshëm si në vetvete ashtu dhe në kushtet e tij të jashtme. Me një përpjekje fillestare për të orientuar nxënësit, mund të ngjallet interesi i tyre për lëndën. Në këtë frymë, shfaqjet dhe paraqitjet teatrale të përgatitura nga nxënësit kishin për qëllim të stimulonin studimin e letërsisë, “*friget enim poesis sine teatro*”. Sugjeroheshin dhe lojra, diskutime dhe të tilla të ngjashme me qëllim që dëshira e të shkëlqyerit të ishte ndihmë në progresin në studim. Këto praktika tregojnë sa është e rëndësishme të bësh interesant studimin e të ngjallësh kështu vëmendjen dhe angazhimin e të rinjve.

(150) **Gjithë këto parime pedagogjike janë të lidhura ngushtë.** Qëllimi i mësimdhënies është rritja e pastër e konceptuar në terma zakonesh dhe aftësish të vazhdueshme. Zakonet nuk zhvillohen vetëm me kuptimin e fakteve dhe të vijueshmërisë, por me aprovimin personal. Aprovimi kërkon një përpjekje konstante dhe ushtrim intelektual. Përpjekja me efikasitet mund të jetë vetëm nëqoftëse ka një motivim të përshtatshëm. Asnjë unazë e këtij zinxhiri nuk ishte e panjohur, por bashkëlidhja e tyre e ngushtë ishte një e re për ato kohë.

(151) Rrjedhimisht për të ndihmuar nxënësit të angazhohen në një veprim apostolik shkollat e Shoqërisë do të duhej t’u ofronin atyre raste për të

thelluar kritikisht vlerat njerëzore dhe për t’i vënë praktikisht në provë. Integrimi personal i vlerave etike dhe fetare është shumë më i rëndësishëm se sa aftësia për memorizimin e fakteve dhe opinioneve të tjetrit. Është e sigurtë që burrat dhe gratë e mijëvjeçarit të tretë do të kenë nevojë për aftësi të reja teknike. Por akoma më shumë do të kenë nevojë për aftësinë të kuptojnë me dashamirësi dhe t’u nënshtrihen me kritikë gjithë aspekteve të jetës në perspektivën e disa zgjedhjeve personale – në fushën personale, shoqërore, profesionale, fetare – që bëjnë më të mirë ekzistencën tonë. Kriteret për këtë rritje – nëpërmjet studimit, reflektimit, analizës, gjykimit, vlerësimit të alternativave të mundshme – janë pashmangërisht të themeluara mbi vlerat. Kjo është e vërtetë edhe pse vlera të tilla nuk shprehen qartë në kursin e studimeve. Në edukimin injacian vlerat e Ungjillit vënë në shenjstër nga *Ushtrimet Shpirtërore* janë normat që drejtojnë zhvillimin human integral.

(152) Rëndësia e metodës ashtu si ajo e përmbajtjeve për të zbatuar këto qëllime është e dukshme. Një qëllim edukativ si i yni – të formosh burra dhe gra për të tjerët – nuk do të mund në të vërtetë të arrihet nëse nuk stimulojmë nxënësit tanë të reflektojnë mbi vlerat të shkaktuara nga lëndët që studiojnë në çdo nivel të zhvillimit të tyre. Kemi mësuar atë që vetëm përvetësimi nuk humanizon automatikisht. Shpresojmë edhe të kemi mësuar që nuk ekziston një edukim pa vlera. Por vlerat e pranishme në shumë aspekte të jetës së përditshme paraqiten në mënyrë të mprehtë. Do të duhet për këtë të zbulojmë për cilat

rrugë nxënësit tanë do të mund të fitojnë zakonet të reflektojnë dhe të gjykojnë vlerat dhe pasojat e tyre për njerëzimin në shkencat pozitive dhe humane që studiojnë, në teknologjitë dhe në spektrin e gjërë të programeve shoqërore dhe politike, që propozohen nga profetë dhe politikanë. Zakonet nuk fitohen rastësisht, por si rrjedhojë e një praktike koherente dhe të programuar. Qëllimi për të zhvilluar e bërë zakonet reflektimin duhet të përpunohet nga të gjithë mësuesit e shkollave të Shoqërisë në gjithë disiplinat, në mënyra të përvetësuara sipas pjekurisë së nxënësve në momente të ndryshme të kursit të studimeve.

## PERFUNDIME

(153) Në misionin tonë të përditshëm bazat e pedagogjisë injaciane mund të jenë të një ndihme të madhe në fitimin e mendjeve dhe zemrave të brezave të rinj. Pedagogjia injaciane përqëndrohet në të vërtetë mbi formimin e personit njerëzor në tërësi, zemër, shpirt dhe vullnet, dhe jo vetëm intelekt; fton studentin të kuptojë nëpërmjet reflektimit kuptimin e asaj që studiojnë, pa mbingarkuar kujtesën; nxit azhurnime që na kërkojnë të gjithë ne gatishmërinë për t'u rritur. Na kërkon të respektojmë aftësinë e nxënësve në nivele të ndryshme të zhvillimit të tyre; dhe i tërë procesi zhvillohet në një ambient shkollor të një vëmendjeje, respekti dhe besimi në të cilin të gjithë mund të përballojnë ndershmërisht

angazhimin shpesh të lodhshëm, të jemi njerëz për të tjerët.

(154) Sukseset tona do të jenë sigurisht gjithnjë më të ulta ndaj idealeve. Por tensioni drejt idealeve, lavdia më e madhe e Hyjit, ka qenë gjithnjë karakteristika e Shoqërisë së Jezusit.

(155) Nëse sot ndjeheni pak në vështirësi për përballimin e këtij angazhimi në paraqitjen e pedagogjisë injaciane mësuesve të kontinenteve tuaja, ta dini që nuk jeni vetëm! Ta dini dhe që përballë çdo dyshim, është mundësia e një pohimi. Ironia e Charles Dickens vlen dhe për kohën tonë: “Ishte më i keqi i kohëve, më i miri i kohëve, pranvera e shpresës, dimri i dëshpërimit”. Dhe jam personalisht shumë optimist kur vë re që në shumë vende të botës ka një dëshirë në rritje për të ndjekur qëllimet e edukimit injacian, që nëse do të kuptohet mirë, do të çojë nxënësit tanë në unifikimin dhe jo në degëzimin; në fe dhe jo në cinizëm; në respektin për jetën dhe jo në shkatërrimin e planetit tonë; në veprimin e përgjegjshëm të bazuar mbi gjykimin moral dhe jo në ikjen e frikshme apo agresionin e çmendur.

(156) Jam i sigurtë se dini që gjërat më të mira të një shkolle nuk janë ata që thuhet, por ata që jetojnë studentët tuaj. Ideali i edukimit injacian kërkon një jetë inteligjence, integriteti, drejtësi dhe shërbim dashurie për vëllezërit tanë dhe për Hyjin tonë. Kjo është thirrja që Jezusi na drejton sot – një thirrje në

rritjen, një thirrje në jetë. Kush do të përgjigjet?  
Kush, nëse jo ju? Kur, nëse jo tani?

(157) Duke përfunduar, ju kujtoj që kur Jezusi la dishepujt e tij, u tha atyre: “Shkoni e mësoni të tjerët!”. I dha atyre një mision. Por ai dinte se ata ishin, dhe që ne jemi, njerëz, dhe që – Hyji e din – shpesh jemi të dëshpëruar. Për këtë thotë akoma: “Kujtoni, se nuk jeni vetëm! Nuk do të jeni kurrë vetëm, sepse **unë do të jem me ju**. Në ministerin tuaj, në momente të vështira ashtu si dhe në momente gëzimi e sukcesi, unë do të jem me ju çdo ditë, deri në fund të kohërave”. Të mos bimë në kurthin e pelagjianizmit, duke vënë gjithë peshën mbi shpatullat tona, pa njohur që jemi në duart e Hyjit dhe që punojmë dora-dorës me Hyjin në këtë minister hyjnor të Fjalës.

(158) Hyji ju bekoftë për bashkëpunimin tuaj. Shpresoj të informohem mbi progresin e Projektit të Pedagogjisë Injacione në pjesë të ndryshme të botës. Ju faleminderit për gjithë atë që bëni!

### Shtesa III

## SHEMBUJ METODASH PER TE NDIHMUAR MESUESIT NE PERDORIMIN E MODELIT PEDAGOGJIK INJACIAN

Vini re: *Këto dhe qëllime e metoda të tjera pedagogjike, koherente me pedagogjinë injacione, do të shpjegohen dhe vihen në praktikë në kurset e formimit të mësuesve, që janë pjesë integrale e Projektit Pedagogjik Injacion.*

### (159) KONTEKSTI I PERVETESIMIT

1. *Nxënësi*: gatishmëri në rritjen
  - a) Situata e nxënësit: analizë e faktorëve fizikë, akademikë, psikologjikë, shoqëror-politikë, ekonomikë, shpirtërorë, që kushtëzojnë gatishmërinë e nxënësit në përvetësimin dhe në rritjen.
  - b) Stile përvetësimi të nxënësve: si të programosh një mësimdhënie efikase.
  - c) Profil i rritjes së nxënësit: një strategji për rritjen.
2. *Shoqëria*
  - a) Lexim i mbresave të kohëve: mjete për analiza shoqërore-kulturore.
3. *Shkolla*
  - a) Klima e shkollës:
  - b) Curriculum
    - formal-informal
    - qëllim e progresion: mundësi ndërlendore
  - c) Edukim i personalizuar

d) Marrëdhënie kolegjiale në mes drejtuesve, mësuesve e personelit ndihmës.

4. *Mësuesi* – parashikimet dhe realiteti

(160) **PERVOJA**

1. Leksioni paraprirës
  - a) Vazhdimësi
  - b) Organizatorë kompetentë
  - c) Objektiva të qartë
  - d) Faktorë humanë interesash
  - e) Kontekst historik i lëndës së studiuar
  - f) Pikëpamje dhe supozime të autorëve të manualeve
  - g) Skema e studimeve
2. Mënyra pyetjeje
3. Veprimtari personale të nxënësve: shënime
4. Zgjidhje të problemeve-Të mësosh të zbulosh
5. Punë në bashkëpunim
6. Punë grupi
7. Emulacion
8. Fundi i mësimit
9. Mbështetje e ndërsjelltë

(161) **REFLEKTIM**

1. Mbikqyrje
2. Shënime personale të nxënësve
3. Stil injacian: përsëritja
4. Studim i rasteve
5. Dilema/Debate/Interpretim rolesh
6. Seminare integrimi

(162) **VEPRIM**

1. Punë personale e nxënësve
2. Përvojë shërbimi
3. Projektim dhe zbatim
4. Zgjedhje e karrierës

(163) **VLERESIM**

1. Detyrë kontrolli: alternativat e mundshme
2. Vetëvlerësim i nxënësve
3. Analiza të sjelljes së nxënësve
4. Këshilla klase e Trupë mësimore
5. Pyetësa për Mësuesit
6. Përpunim i profileve të nxënësve

## Shënime

1. Shih karakteristikat, 167 dhe Peter-Hans Kolvenbach S.I., Fjalim i mbajtur në Georgetown, 1989.
2. Të tilla janë shekullarizmi, materializmi, pragmatizmi, utilitarizmi, fundamentalizmi, racizmi, nacionalizmi, konsumizmi – për të mos përmendur të tjera.
3. Dekreti 1°, 42-43. Nënvizimi është i yni.
4. Ky aspekt themelor i modelit injacian të *Ushtrimeve Shpirtërore* dhe implikimet pedagogjike është studiuar nga François Charmot S.I. në *Le Pédagogie des Jésuites: Ses principes - son actualité* (Paris, Aux Editions Spes, 1943). “Një informacion i mëtëjshëm mund të gjendet në dhjetë kapitujt e parë të direktoratit të *Ushtrimeve Shpirtërore*. Të zbatuara në edukim, ata vënë në dukje parimin pedagogjik sipas të cilit mësuesi nuk duhet thjesht të informojë, por duhet të ndihmojë nxënësin të ketë progres në të vërtetën”. (Shënim, që përmbledh seksionin në të cilin Charmot përshkruan rolin e mësuesit sipas Ushtrimeve, shkëputur nga një përktim i shënuar i disa pjesëve të librit të Charmot bërë nga Michael Kurimay S.I.).
5. Metoda e kurseve të katedrave, në të cilin autoriteti i profesorit (*magister*) si shpërndarës i dijeve sovraane, bëhet metoda pedagogjike predominuese në shumë shkolla duke u nisur nga Mesjeta. Leximi me zë të lartë i leksionit karakterizonte kursin, që studenti do të duhej më pas ta mësonte dhe mbronte. Zhvillimet e stampës bënë të gatshëm një numër më të madh librash për leximin privat dhe një studim të pavarur. Në kohët më të fundit, tekste dhe materiale didaktikë përgatitur nga kompetentë dhe të publikuar në masë të gjerë në treg kanë patur pasoja shënuese mbi Mësimdhënien. Në shumë raste teksti ka zëvendësuar mësuesin si një burim parësor i kursit, aq sa zgjedhja e manualit mund të bëhet shpesh zgjedhja më e rëndësishme për mësuesin. Përcaktimi i programit në funksion të kapitujve dhe faqeve të teksteve vazhdon të jetë norma në shumë raste. Shpesh mendohet pak ndaj ndikimit që dije dhe ide të shprehura në kuadrin e një disipline mund të kenë mbi mënyrën në të cilën nxënësit marrin vesh lëndën dhe drejtojnë e kuptojnë botën në të cilën jetojnë.
6. Mjafton të mendosh për çka ishte periudhë e mësimit të profesionit për të kuptuar që jo të gjitha pedagogjitë ishin kaq pasive kundrejt atij që mësonte.

## Treguesi

	faqe
Paraqitje . . . . .	3
Shënime hyrëse . . . . .	7
Pedagogjia injaciane . . . . .	12
Qëllimi i edukimit injacian . . . . .	12
Drejt një pedagogjie për fenë dhe drejtësinë . . . . .	15
Pedagogjia e Ushtrimeve Shpirtërore . . . . .	20
Marrëdhëniet mësues-nxënës . . . . .	22
Modeli injacian . . . . .	24
Dinamika të modelit injacian . . . . .	27
Një proces i vazhdueshëm . . . . .	44
Tipare karakteristike të Modelit Pedagogjik Injacian . . . . .	45
Sfida për aktualizimin e një pedagogjie injaciane . . . . .	48
Nga teoria në praktikë: programe formimi për mësuesit . . . . .	54
Ndihma në bashkëpunim . . . . .	55
Shtesa	
Shtesa I: Disa parime themelore të pedagogjisë (“Shënime” injaciane) . . . . .	59
Shtesa II: Pedagogjia injaciane sot Atë Peter-Hans Kolvenbach, S.I. . . . .	63

	faqe
Shtesa III: Shembuj metodash për të ndihmuar mësuesit në përdorimin e Modelit Pedagogjik Injacion . . . . .	85

USHTRUES                    HYJI  
NXENES                    E VERTETA

DOCENT  
DREJTUES

REFLEKTIM                    VEPRIM

PERVOJE

- |      |     |     |      |     |     |
|------|-----|-----|------|-----|-----|
| (61) | (2) | (3) | (4)  | (5) | (6) |
| (7)  | (8) | (9) | (10) |     |     |